



JETA E ELENA GJKËS

Dora d'Istrias



JETA E ELENA GJIKËS

Dora d'Istrias

92
B22

VEHBI BALA

R

JETA
E ELENA GJIKËS
(DORA d'ISTRIAS)

34812 41256

SHKURTËR
SHITE

SHËTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»



Elena Gjika

«...Ma e fuqishme se një skeptër uroj
që kjo pendë, deri në frymën time të
fundit, të përdoret për të mprojtë nderin
dhe të drejtat e Shqipnisë, atdheut tim të
nderuem».

Dora d'Istria
1881

KAPITULLI I PARË

NGA VLLAHIA NË PETROGRAD

«Po ta shikosh hieshinë e saj fisnike,
Përher' kujtimin në zemër do ta
kesh»

Eliade Rëdulesku

Në një ditë të ftohtë dimni të vitit 1829, u lind 1) ajo që do të quhej Elena Gjika, por që do të bahej e pavdekëshme me emnin letrar Dora d'Istria.

U lind në kohën e një ndeshjeje të furishme mbi dallgët e Detit të Zi midis rusëve dhe turqve. Me paqen e Adrianopolit, më 14 shtator 1829, hyni në fuqi traktati që do t'u jipte princënivet danubiane disa të drejta: autonominë administrative, lirinë e tregëtisë, sigurimin e kufivet. Tash e tutje, prodhimet e bujqësisë dhe të blegtorisë, të çlirueme nga monopoli turk, mund të shiteshin me çmime ma të nalta dhe me sasi ma të mëdha në Evropë, nga e cila mund të bliheshin mallnat industriale. Ky shkëmbim i dendun mallnash midis vendeve kapitaliste dhe princënivet danubiane, të cilat gjindeshin në një gjendje ekonomike mjaft të prapambetun, do të shpejtonte shndërrimet në strukturën ekonomike, shoqnore dhe politike të këtyne dy shteteve rumune, të futuna nga ditë e ma shumë në rrugën e zhvillimit të ekonomisë kapitaliste. Por sundimi feudal turk e frenonte zhvillimin e kësaj ekonomie në Evropën

jugë lindore. Pakënaqësia ndaj këtij sundimi pat gjetë shprehjen në kryengritje të herëpashërëshme të popujve të ndryshëm të gadishullit ballkanik. Ende të freskëta ishin ato që kishin udhëhequn Karagjorgji, Ypsilanti, Tudori. Elena Gjika do të shënojë ma vonë:

«Në vitet e para të qenies sime, kam pamë
Greqinë tue dalë nga varri»²⁾

Protectorati rus mbi princënitë danubiane qëndroi nga maji 1828 deri në prill 1834, d.m.th. derisa Elena mbushi pesë vjet. Lufta la shkatërrime dhe të liga të mëdha. Që kur Elena ishte tre vjeçe, në jugë të Danubit pat ramë kolera dhe, nga mungesa e bukës, qe përhapë zia. Megjithatë, në popujt e Vllahisë dhe të Moldavisë zunë të piquen dhe të forcohen mendimet e mvehtësisë së plotë kombëtare, dëshirat për përparimin mbi themelet e këndim-shkrimit në gjuhën amëtare. Në korrik 1831, në Vllahi, dhe në janar 1882, në Moldavi, u vu në zbatim *Rregullimi Organik*, sipas të cilit të gjitha të drejtat si shtet i takonin buerësisë, ndërsa doganat e mbrendëshme midis tregjeve dhe qyteteve u hoqën, gja që i dha dorë ekonomisë së vendit dhe forcimit shtetnor. Fshatarët mbetën prap nën barrën e randë të shfrytëzimit bujer. Por me *Rregullimin Organik* u hodhën bazat e bashkimit të të dy princënivet në një shtet të vetëm kombëtar. Një nga dy zotnitë sundues, të quejtun «Domnii Regulamentari», ishte Aleksandër Gjika, ungji i Elenës, në Vllahi.

Aleksandri qëndroi si zot i Vllahisë që nga 1834 deri më 1842. Sa qe ky në fuqi, sidomos më 1841, u ndez një konflikt midis tij dhe bujerëve, të cilët, me anë të *Kuvendit të Përgjithëshëm të Zakonshëm*,

ma fort për të mprojtë interesat e klasës së sa dinjitetin kombëtar, e shpallën Aleksandrin shkelës të *Rregullimit Organik* dhe e dëbuen nga pushteti, më 1842. Ndërkohë, u çfaq një lëvizje shoqënore: juristi i ri Dhimitër Filipesku, posa i kthyem nga Franca, grumbulloi rreth vehtes një grup atdhetarësh përparimtarë, ndër të cilët edhe Nikolae Bëllçeskun, dhe krijoi një *Komitet Revolucionar*, që kërkonte «të tërhiqte zanatçijtë dhe punëtorët për anë tregëtarëve dhe intelektualëve». Ky Komitet nisi të diskutojë përpilimin e një projekt-kushtetute, me qëllim që të çrranjoste paradrejtat bujere, të çlironte bujkrobët dhe të themelonte republikën. Kjo lëvizje, që paralajmëroi revolucionin e vitit 1848, forcoi rrymën kryengritëse të viteve 1843-1847. Për çlirimin e bujkrobëve nisi një lëvizje në Transilvani, në ballë të së cilës doli grueja me prejardhje maxhare, Katerina Varga, e quejtun nga fshatarët «Zonja e mocëve». Fryma kryengritëse po depërtonte thellë në masat, e ushqyeme nga shoqatat kulturore dhe nënshtresë politike, sidomos nga ajo që u quejt *Fratia* (Vëllaznia»). Ishte vazhda e natyrëshme e kryengritjes së vitit 1821, që kishte udhëheqë Tudor Vladimiresku dhe në të cilën morën pjesë edhe shqiptarë të ngulun atje, në Vlasi, si Naum Veqilharxhi me shokë.

Në këto rrethana u lind dhe kaloi vitet e para të fëmënisë Elena Gjika. Në to mori pjesë edhe familja e saj. Ndërsa i ungji, Aleksandër Gjika, u ba «Zot Rregullimtar», i ati, Mihajl Gjika, ishte qeveritar, ministër i punëve të mbrendëshme («mare vornic») i Vllahisë në Bukuresht, që nga viti 1835 deri në vitin 1842, d.m.th. pikërisht në atë periudhë kur sundoi atje Aleksandri. Mihajli u detyruë të largohet nga detyra dhe nga vendi më 1842, për t'u kthye ma vonë si anëtar i Këshillit të Epër të Arë-

simit, derisa vdiq, më 1850, në moshën pesëdhjetetëvjeçare. Ky burrë ishte i njohun si mbledhës antikitetesh. Baza e muzeut të antikiteteve në Bukuresht do të jetë një trashëgim i lanë prej tij. Ai ishte edhe i dhanë pas shetitjeve. Nga i jati, me sa duket, Elena mori si pajë shpirtnore pasionin për sendet e moçme, që ruejnë vlera të pashlyeshme gjatë kohëve, kultin e qytetnimit të lashtë, andjen e shtegëtimeve nëpër botë. E ama quhej Katerina. Thuhet se edhe kjo, si i shoqi, ishte e stolisun me një kulturë të gjanë, por, mbi të gjitha, e pajisun me prirje letrare. Me gjasë, nga e ama, Elena trashëgoi etjen për të fitue dije dhe për të lërue shijen letrare.

E ama e përgatiti bijën e vogël që të ndiqte shtigjet e arteve.

Elena qëndroi në Vllahi deri në moshën trembëdhjetëvjeçare.

Në Bukuresht, sikurse edhe në qytete dhe fshatra të ndryshme, princesha e mitun nisi një jetë të pasun, ndonëse në rrethana të ashpra politike dhe në pasoja të këqia që la lufta ruso-turke. Ajo bani hapat e parë në jetë nën kujdesin e prindëvet aq të ngritun dhe nën drejtimin e një preceptorit të rrallë të quejtun Grigor Papadhopulli, maqedonas i ditun, filozof dhe psikolog në za në viset ballkanike.

Në Malet Perëndimorë («Munti Apuseni»), ku ishin ngulë pirustët ilirë, këta minatorë të fortë, që Roma i kishte shpërngulë dikur nga Iliria dhe i kishte çue në Daki për të nxjerrë dhe punue metalet, në luginën e Danubit, që nga Konstanca, Këllërashi, Bukureshti dhe deri në Moldavi, si barij a si ndër-tues në krye të herës, si luftëtarë, rojtës a olofe-xhij, si kërkues të jetesës a të mërguem politikë ma vonë, u ngulën bashkëatdhetarë tanët, shqiptarë nga Toskënia, Dibra dhe Kosova, të cilët ruejtën shpesh

doke dhe shprehi, derisa u lidhën pazgjidhshmë-nisht me tokën dhe popullin strehues. Me prejardhje shqiptare ishin tri familje të njohuna sunduese në Vllahi dhe në Moldavi: Lupujt, Dukajt dhe Gjikajt. Që në fëmëni, Elena do të ketë dëgjue për prejardhjen shqiptare të familjes së vet, si dhe për vendosjen e bashkatdhetarëve të parë nëpër viset rumune. Që atëherë, në fëmëni, ajo do të ketë dëgjue jehonën e madhe që kishte shkaktue në Vllahi dhe në Moldavi lufta e vendosun e shqiptarëve, nën drejtimin e Ali Pashë Tepelenës, kundër Turqisë, siç dëshmohet nga një lajm prej Vjene, më 25 mars 1821, që thoshte se: «Kryengritja në Vllahi dhe në Moldavi, po merrte një karakter serioz».

Shembulli i Ali Pashës kishte dyfishue guximin e kryengritësve — thoshte, më 5 prill 1821, *Journal des Débats* ³⁾. Ajo do të ketë dëgjue edhe për pjesëmarrjen e shqiptarëve si Naum Veqilharxhi me sho-kë në kryengritjen e fshatarësisë rumune, nën udhëheqjen e Tudorit, më 1821, kundër sundimit turk dhe shfrytëzimit bujer.

E squetë, e shkathët, e bukur, e aftë për të thithë dije dhe për t'u stolisë me kulturë, Elena mori një zhvillim të rrallë për moshën e vet të njomë. Rrëfente preceptorin e saj i mirënjohun rreth nxanësës së vet dhe përmendte disa predispozita, që, në rrethana të volitëshme, shpërthyen si gonxhë, si lule të erandëshme e të shumëngjyrëshme. Gjenia e prince-shës Elena, tregonte preceptorin, u zhvillue para kohe, mirësia engjëjlore e zemrës së saj, dhantitë e tjera të natyrës, ishin shkaku që njerëzit e rrethit të saj ta adhuronin dhe, njëheri, ta kishin për stoli të oborrit princënor të Aleksandrit. Ndërsa gjimnastika i zhvillonte trupin në mënyrë të harmonishme, squetësia e hijeshonte nga ditë e ma shumë. Preceptorin

përdorte ecuni të reja mësimi, sepse ajo kërkonte ma shumë dhe i përvehtësonte me lehtësi ato dije që të tjerët zakonisht i kapin me vështirësi. Që në veçjëli, tek ajo dallohej një shije e veçantë. Në moshën njëmbëdhjetëvjeçare, Elena u vu të krijonte një novelë. Larg çdo fryme kotësie femnore, vazhdon të rrëfejë Papadhopulli, ajo interesohej me nxanë diçka ma tepër se sa i jepte libri i historisë që kishte nëpërduer: kërkonte burime të reja. Lexonte shumë letërsi të vjetër dhe të re. Nuk rrinte në vetëmi. Kur do të rritet, ajo do të shkruajë një vepër të fuqishme kundër jetës murgare dhe dogmatizmit kishëtar. Që në pranëverën e moshës së vet, ajo prirej drejt jetës së gjallë, synonte të përfitonte nga ditunitë dhe të shijonte bukuritë e botës rreth e përçark. Poeti rumun Eliade Rëdulesku, që e ka njohtë Elenën të vogël, e përshkruen si një krijesë të hirëshme:

*Po ta shikosh hieshinë e saj fisnike,
Përher' kujtim në zemër do ta kesh. 4)*

Elena do të kujtojë ma vonë disa nga ngjarjet që e kanë prekë ma shumë. Preceptorin e vet do ta nderojë gjithnjë si një pris të dashun në udhën e ditunitë. Tue shprehë evari për të, Elena do ta ndihmojë ma vonë në përmbledhjen e tij frengjishte **L'Orient Chrétien**, tue i dërgue një punim rreth shkrimtarëve arbëreshë të Italisë jugore.

«E kam besue si diçka të dobishme me i dërgue kësaj përmbledhjeje, që duket se asht caktue të ushtrojë ndikim mbi njerëzit e Lindjes, një punim kushtue krejtësisht shkrimtarëve arbëreshë të Italisë jugore...»

do të shënojë ma vonë, 5) tue shpresue se **L'Orient**

Chrétien e ish-preceptorit të saj do të luente një rol të mirë për çështjen shqiptare në Evropën jugë-lindore.

Kur Elena mbushi trembëdhjetë vjet, i ati, i hequn nga detyra, ashtu sikurse edhe i ungji, e mori me vehte bashkë me preceptorin e njohun, në rrugën e vështirë të mërgimit politik, nëpër dhë të huej. Atëhere e shohim Elenën në Vjenë, Berlin, Dresden. Ky shtegëtim nëpër Evropë, krahas dhimbjes së largimit nga vendlindja, i sillte edhe një dobi të madhe: e pasunonte me njohuni të reja. Evropa e dhjetëvjetëshit të pestë të shekullit të kaluem po ziente nga zjarmia e kryengritjes shoqnore. Elena ishte ende larg ngjarjeve të flakta, që do ta çonin peshë vegjëlinë dhe do t'i tronditnin shtresat e nalta. Por udhës së dijes dhe artit nuk iu nda. Në moshën katërbëdhjetëvjeçare u vu të përkthejë gjermanisht nga origjinali Iliadën e Homerit. Tregojnë se një herë, në oborrin e mbretit të Prusisë Fridrih Vilhelmit IV, pasi ky i kërkoi Aleksandër Humboldt, dijetarit të famshëm gjerman, që t'i lexonte disa shkrime të vjetra greqishte të gdhenuna mbi një basreliev, dhe Humboldi nuk ja doli atypëraty, Elena, që qëlloi përënë, i lexoi me shikimin e parë.

Në shtegëtim, ajo nuk reshti së studiuemi. Përveç Papadhopullit, si mësues për arte të bukura ajo pati Çikarelin, Persianën, Ronkonin, Balfan. Ma vonë, studioi pikturë edhe me Felice Skiavonin, i cili, bashkë me Adolf Salmonin, punoi një portret fort të bukur për 'të. Ndërkohë, ajo përvehtësoi shumë gjuhë të hueja. *Larousse-i*, fjalori i madh universal i frengjishtes, shënon për këtë punë:

«Princesha Elena njihte thellë italishten, anglishten, gjermanishten, frengjishten, ruma-

nishten, greqishten, latinishten, ruishten dhe shqipen». ⁶⁾

Shqiptimin dhe theksimin e tyne thonë se e bante në një mënyrë të tillë, sa që të besohej se ishte e popullit, gjuhën e të cilit fliste. Me anë të këtyne nandë gjuhëve, Elena fitoi, që e re, një kulturë aq të gjanë, sa që spanjoli Yriarte do ta quejë «enciklopedi e gjallë» ⁷⁾.

Punoi disa kuadro piktore. Si piktoe, ajo mori pjesë, gjashtëmbëdhjetëvjeçare, më 1845, në eskpozitën e arteve figurative të Dresdenit, dhe të hollat që fitoi nga kuadrot e shituna ua dha të vorfënve ⁸⁾. Nandë vjet ma vonë, ajo do të marrë pjesë edhe në një ekspozitë tjetër, në Petrograd.

E re, kaq e talentueme, e ditun dhe e hieshme, princesha tërhoqi menjëherë vemendjen e shoqnisë së naltë. Kishin marrë famë në atë kohë disa personalitete grash: shkrintaret frenge Zhorzh Sand dhe Kontesha d'Agou (d'Agoult), të cilat vazhdonin përpjekjet krijimtare të pararendëses së tyne bashk-atdhetare, Zonjës de Stael, artiste e fjalës me prirje liberale. Disa jetëshkrues të Elenës kanë gjetë mjaft tipare të përbashkëta midis kësaj dhe tri fytyravet të njohuna të letërsisë frënge. Ka, vërtet, disa tipare të tilla, por ka edhe veti që e dallojnë jo pak Elenën tonë prej tyne. Sidoqoftë, kur shkrintarja jonë u kap në të njëzetat, Zhorzh Sandi — pseudonim i baroneshës Dydëvant, Oror Dypen, — e cila e nisi karrierën letrare me romane sentimentale dhe shoqnore, plot imagjinatë romaneske dhe psikologjisjeje, po kalonte të dyzetekatërtat: kurse tjetra shkrintare, Kontesha d'Agou, — Marie de Flavinji, me pseudonimin Daniel Stern, — e cila krijoi vepra historike dhe filozofike, me një stil energjik e burrëror, kishte mbu-

shë të dyzetetretat. Kur vdiqën dy shkrimtaret frenge, më 1876, Elena jonë arriti kulmin e lavdisë, aq sa princi i Rumanisë, Karoli I, i dërgoi Urdhnin e shkallës së parë «Bene Merenti», vlerësim që në Perëndim, sikurse edhe në Lindje, ishte e para herë që i bahej një grueje, sepse zakonisht ky Urdhën caktohej vetëm për dijetarë. Në Evropë, pas Zonjës de Staël, Sandit dhe t'Agu-jt, po vinte një shkrimtare e re, jo ma pak e famëshme — Dora d'Istria.

E, pra, kur Elena po mbushte njëzet vjetët, u martue me princin rus Aleksandër Kolcov-Mosallskin, pinjollin e shtëpisë së Rurik Normandit, themelese e perandorisë së carëve të Rusisë. Me një pajë kaq të çmueshme squetësie, kulture dhe hieshie, Elena Gjika, tek e cila zunë të zhvillohen tashti rryma fort të gjalla drejt lirisë politike dhe fetare, vajti në Petrograd. Qytet i themeluar nga Pjetri I, Petrogradi ishte i njohun në botë si një qendër e madhe administrative dhe tregëtie, seli kulture, arti, shkence dhe feje, me universitet, akademi, shoqata diturake, biblioteka të pasuna, me një arqitekturë magjepsëse, ku dalloheshin rrugët e drejta, urat e bukura mbi Nevë, Pallati i Dimnit, përmendoret. Për rusët dhe Rusinë, Elena kish dëgjue që në vegjëli, kur mbi dy princënitë rumune qëndronte protektorati i asaj perandorie. Në fron ishte car Nikolla I, i cili, në vitin kur u martue Elena me princin Kolcov-Mosallski, ndihmoi Austrinë për të shtypë kryengritjen maxhare. Ishte viti 1848, viti i lëvizjeve shoqnore dhe kombëtare në Francë, Itali, Rumani dhe gjetiu. Jehona e tyne, me siguri, la mbresa të forta te Elena. Ndër sa e sa ngjarje heroike, ajo me siguri do të ketë dëgjue rreth veprimit guximtar të rumunes Ana Ipëtesku, që vazhdonte kreshnikinë e Katerina Vargës.

Martesa me një princ e lidhi atë ndaj shtresës ma të naltë të shoqënisë petrogradase, tek e cila ajo njohu lustrën, puthadorjen, prishjen morale, veset ma të urryeshme për një të re të ushqyeme me mendime dhe dëshira fisnike në jetë. Krahas botës laike luksoze, ajo njohu atje edhe rrethin e errët fetar, që mbahej nga murgënia dogmatike. Por, si artiste, ajo nuk qëndroi mb'anë. Më 1854, gjashtë vjet pasi arriti aty, mori pjesë në Ekspozitën e arteve të bukura, ku fitoi një çmim të argjandë.

Një ditë prej ditësh, tek po shetiste anës së Nevës, një grue ra në ujë dhe qe në rrezik të mbytej. Elena, sa e pa, ndonëse vetë jo në gjendje të mirë shëndetësore, u hodh mbi valë dhe e shpëtoi gruen e humbun.

Pas pak vjetësh martese, i lindi një djalë, por burri i vdiq dhe ajo, më 1855, mbas shtatë vjetvet, nuk qëndroi ma n'atë rreth, që, për' të, ishte i huej, sadoqë jeta kulturore e Petrogradit do t'i linte një mbresë të pashlyeshme. Kur Elena pat arritë aty, ishin ende të freskëta kujtimet e disa ngjarjeve të thekëshme letrare. Njëmbëdhjetë vjet ma parë Pushkini dhe shtatë vjet ma parë Lermontovi, dy poetët ma të mëdhej të Rusisë ishin vramë në duel; katër vjet ma parë kishte mbyllë sytë babai i përrallëzës ruse, Krillovi; po atë vit, ishte shue ylli i demokracisë revolucionare ruse, kritiku i shquem Bjelinski, ndërsa jashtë, i mërguem, ngrihej i kumbueshëm zani i atdhetarit të flaktë Hercen. Por, me gjithë atmosferën e randë cariste, jeta letrare vazhdonte. Me të vërtetë atmosferë e randë, përderisa sundonte një car, i cili kish ramë aq poshtë, sa të lexonte tinëzisht letrat që Pushkini ia kish dërgue së shoqes. Kur këtë punë e pati marrë vesh poeti, pati shkruë:

«Ç'immoralitet i thellë në sjelljet e qeverisë sonë. Policia çel letrat e burrit drejtue grues dhe ja jep carit (njeri me shkollë dhe me edukatë të zgjedhun) që t'i lexojë, dhe carit nuk i vjen turp që ta njohë këtë çështje dhe të sendërtojë një intrigë të denjë për Vidokun dhe Bulgarinin. S'ke ç'i thue, punë e ngatrrueme kjo puna e monarkut!»

Jo. Elena jonë, megjithëse bijë princi, nuk ishte gatue për një rreth të tillë të molisun nga këso farë veshesh cariste. I dhimbsej Petrogradi që nuk do ta shih-te ma? Natyrisht. Por nuk duhej qëndrue aty. Lam-tumirë, Petrogradi i shkencës, i kulturës dhe i arteve! Lamtumirë, Rusi e një populli të madh!

Me foshnjën në krah, Elena njëzetegjashtë vje-çare u largue për gjithmonë nga Petrogradi, nga Ru-sia. Dhe nuk u kthye në vendlindje, në Vllahi. I ati kishte vdekë, më 1850; edhe e ama, gjithashtu. U nis për Evropë, që të marrë udhët e vështira të mërgimit dhe shtigjet e reja të arteve dhe të ditunisë; të kriji-mit dhe të veprimit qytetar.

1) Në lidhje me datën dhe vendin e lindjes, disa jetë-shkrues të Elena Gjikkës japin njohtime të ndryshme. *Larousse*, Grand Diction. du XIX-e siècle, v. VI, Paris, 1870, f. 1107, shenon: Bukuresht 1829. Amante Bruto, në *La Romania Illustrata*, botue në Romë, më 1888, f. 215, sjell si datëlindje 3 shkurt 1828. Jani Pema, në artikullin përkujtimor *Dora d'Istria*, botue në *La Nazione Albanese*, viti II, 28 shkurt 1898. Nr. 4, shenon: Bukuresht 1829. *Enciclopedia Italiana*, ed. Treccani, V. XVI, 1932, në zanin Ghica, jep gjithashtu vitin 1829. J. Kastrati, në artikullin përkujtimor *Dora d'Istria*, në fletoren Luftëtari, më 22

mars 1962, f. 3, jep: Konstancë 22 janar 1828. *Historia e Shqipërisë*, vëllim II, botim i I.H.G.J. së U.S.H.T., 1965, f. 101 shenon 1829. Përmendëm vetëm disa burime, nga të cilat njoftimi i *Larousse-it* na duket ma i sakti, sepse u dha atëherë kur Elena ishte gjallë dhe ndoshta në dijeni të shkrimtares. Mirëpo, nëqoftë se për vitin e lindjes nuk ka aq ndryshim, për vendin e lindjes puna paraqitet ma e ndërlikueme. Ndërsa të gjithë jetëshkruesit, qoftë për të gjallët të Elenës, qoftë pas vdekjes së saj, japin për vend të lindjes ase qytetin Bukuresht, ase qytetin Konstancë, vetë Elena, në vëllimin e parë të veprës *Les femmes en Orient* (Gratë në Lindje), botua në Zurih më 1859, rijep letrën që ja kishte pasë dërgue një mikeshë së vet dhe në të cilën shkruen: «Jam lindë mbi brigjet e Shqipnisë së Jugut, jo larg maleve të Sulit, në qytetin e Pargës, me fatin e keq të së cilës, disa vjet mbas ramjes së Napoleonit u muer mbarë Evropa... Parga ime e dashun, e cila me shekuj nuk pat kundrue gjysmëhanën mbi muret e veta, Parga iu dorëzue të pamëshirëshmit, vezirit të Janinës, Ali Pashës, i cili, që prej kohësh, e gjakonte këtë qytet të krishtenë, të cilit nuk ja falte fajin për ndihmën që u pat dhanë panda herojve të Sulit. Një qytet prej 4000 shpirtësh iu shit myslimanëve prej Thomas Maitland, komisar i naltë anglez i ishujve të Jonit, për 150.000 lira. Pargan jotët e përbuzën me neveri këtë çmim të tokës së lindjes së tyne dhe preferuen ma mirë me marrë rrugët se sa me jetue skllavë në dorë të të pabesëvet... Prindët e mi, si gjithë bashkatdhetarët e tyne, zgjodhën mërgimin mbi kularin e muhamedanëve. Mbasi dolën në Korfus e mandej në Trieshtë dhe kaluen mbretnin lombardo-veneciane, u hodhën në Bernardino dhe erdhën e u vendosën në brigjet e liqentit Zurih, ku të krishtenët e lindjes gjetën përherë simpatinë ma të gjallë. Por mjerimet që pësuen shterrën forcën e prindëve të mi. Nana më vdiq e para me emnin e Pargës ndër buzë, e nuk vonoi shumë këtë e ndoqi në varr edhe baba. Pastori Hermann,

njeri sa i ndritun aq zemërbardhë, më mori nën mbrojtje të vet bujare dhe më trajtoi njënjë me vajza të veta. Halla jote, zonja dukeshë de Milly, vinte aso kohe me kalue verën në vilën e vet të bukur në Staefa. Zotni Hermann ja tregoi historinë time dhe i foli për mue me dhimbsurinë e vet të zakonëshme. Ajo më mori dhe më propozoi që unë të zejsha vendin e fëmijvet të asaj që Zoti nuk ja kishte falë. E vejë dhe pasanike, dukeshja nuk kurseu asgja për zhvillimin tim. Mbas më lëshoi ndër duer të një instrukticeje gjeneveze, desht dhe ajo vetë me ndërhy me të tana hollësitë në edukimin tim. . . » (përkth. shqip nga frengj. J. Tafilaj, dorëshkrim). Po të ishte i vërtetë ky rrëfim i autores, shkruie me një farë fryme romantike, atëherë të gjitha të dhanat e tjera, tue fillue që nga *Larousse-i* i vitit 1870, d.m.th. 11 vjet pas botimit të vëllimit të parë të veprës *Les femmes en Orient*, ku doli në dritë letra e sipërthanë, dhe tue mbarue me shënimet ma të reja për datën dhe vendin e lindjes së Elenës, pas vdekjes së saj, bijnë të gjitha poshtë si të pasakta. A thue të gjithë këta jetëshkrues të saj nuk ishin në dijeni për veprën *Les femmes en Orient*, ku u botue letra e Elenës vetë? Nuk asht për t'u besue. Po atëherë, si spieghet gjithë kjo punë? Përse vetë Elena Gjika nuk kundërshtoi të dhanat për jetën e saj që botuen *Larousse-i* i vitit 1870, E. Artomi, G.G. Peretz, etj. për të gjallë të saj? Përse ajo, në letërkëmbimin me De Radën, tregon se preceptor i saj i fëminisë ishte Gjergj Papadhoppulli, në përmbledhjen frengjishte të të cilit, *L'Orient Chrétien*, bashkëpunoi ajo ma vonë me vepërzën rreth shkrimtarëve arbëreshë të Italisë Jugore? Si qe e mundun që poeti i shquem i kohës në Vllahi, Eliade Rëdulesku, ta njihte në oborrin princënor të Gjikaëve dhe t'i thurte një poezi të njohun Elenës së vogël? Mbi të gjitha, si asht e mundun që shënimet për atin e saj, që historia rumune e tregon si «mare vornic» në Bukuresht, që nga 1835-a deri më 1842, d.m.th. për 7 vjet me radhë,

deri kur Elena ishte në moshën trembëdhjetë vjeçare, të mos jenë të vërteta?

Për të gjitha këto çështje, nuk po i përmbahemi rrëfimit të Elenës në letrën që botoi në *Les femmes en Orient*, por dëshmime që dalin nga burimet e tjera të njohuna si të vërteta.

2. Letër e Dora d'Istria-s dërgue Jeromin De Radës nga Livorno, më 15 tetor 1866 (*Fondi De Rada, A.Q.SH.*; dosja Nr. 338 536, 54/1).

3. sp. Mile Ligor: *Tepelenasi dhe Turqia*, në Ylli, viti VI, qërshor 1965, f. 25.

4. *Operele Doamnei Dora d'Istria*, trad. de G.G. Peretz. Bucuresti, 1876, fq. 97.

5. Letër e D. d'I. dërgue J. de Radës, po aty.

6. *Larousse, Grand Dictionnaire Universel du XIX-e siècle*, tome sixième, Paris, 1870, f. 1107.

7. sp. *Dora d'Istria: La nazionalità albanese secondo i canti popolari*, trad. di E. Artom, Cosenza, 1867, f. 6.

8. *Bruto Amante: La Romania Illustrata*, ricordi di viaggio, Roma, 1888, f. 216.

KAPITULLI I DYTË

NË BELGJIKË, NË ZVICËR

«...dy diamanta psikologjie të shkallës së parë, ku, pa u lëshue ndër katastrofa dramatike ase në të dhanë hov të tepruem ndiesive, ajo len zgjuet vërejtjen tonë, na prek mu në zemër».

P. Mantegaca

Ende e re, njëzetegjashtëvjeçare, e zhgënjyeme nga martesë fatzezë, e rame nga shëndeti, Elena Gjika largohet përgjithnjë nga Rusia dhe shkon në Belgjikë. I vdes dhe foshnja e mbetet fill e vetme. Ç'udhë të jetës me marrë?

Dhjetëvjetëshi i parë i gjysmës së dytë të shekullit XIX në Evropë, pas ngjarjeve të zjarra të dyzet e tetës, paraqiste një tablo karakteristike: zhvillimin e shpejtë të industrisë dhe kërkesën e madhe të tregjeve të reja për prodhimet e saja. Megjithatë, Austria, Franca dhe Prusia, të mbetuna si të paralizueme nga përpëlitjet e brendëshme, ndieheshin jo krejt të afta për të ndërhy në Evropën jugë lindore. Vetëm Anglia i hapte sytë gapërr me Rusinë, e cila posa i kish dhanë goditje të randa Turqisë. Në një

ndërlikim të ri interesash midis fuqive të mëdha për të kapë tregje të reja, plasi lufta midis Rusisë, mbë n'janë, dhe Turqisë, Anglisë dhe Francës, mb'anë tjetër, — lufta e Krimesë. Në shtator të vitit 1855, ra Sevastopuli. Më 30 mars 1856, u vendos në Paris traktati i paqës.

Në Vllahi, përsëri erdhi në fuqi ungji i Elenës, Aleksandër Gjika. Po në Paris, më 1858, konferenca e të shtatëvet vendosi bashkimin e të dyja princënitvet danubiane, Vllahisë dhe Moldavisë. Më 24 janar 1859, «Zot» i të dyja princënitvet u zgjodh Aleksandër Jon Kuza. Këtë bashkim ua kish kërkue me kohë fuqive të mëdha princi i Moldavisë, kushërini i Elenës, Grigor Aleksandër Gjika.

Ndërkohë, në prill të motit 1859, shpërtheu një tjetër ndeshje: lufta midis Italisë dhe Austrisë. Nga afër a nga larg, të gjitha këto ngjarje të bujëshme i ndoqi Elena. Por ma me vemendje, në këtë periudhë, ajo ndoqi ngjarjet e vendlindjes, sidomos ato të arësimit dhe të kulturës.

Në Vllahi dhe në Moldavi, bujerësia nuk e çante kokën për ngritjen kulturore të fshatarësisë; borgjezia kërkonte t'u jipte arësim masave vetëm aq sa i nevojitesh asaj për tregëtinë dhe industrinë. Më 1859, në Bukuresht u themelue fakulteti i së drejtës, të cilin e pasuen ai i shkencave dhe i letërsisë. Ende ma parë, Grigor Aleksandër Gjika i kish dhanë dorë arësimit, tue themelue, ndër të tjera, shkollën e arteve dhe mjeshhtërive, si dhe atë të kirurgjisë në Jash. Më 1860, u krijuen nga një konservator dhe nga një shkollë artesh të bukura në Jash dhe në Bukuresht. Por shumë të rij, bij bujerësh dhe borgjezësh të pasun, dilnin për studime jashtë vendi. Vetëm në Paris, më 1859-1860, ndiqnin mësimet qinda nxanës dhe studentë rumunë. Në atë kohë, ishin bamë një nevojë e ditës

fletoret për tregëtinë, politikën dhe kulturën. Që më 1855, në Jash, dolën dy organe të randësishme: fletorja *Steaua Dunarii* («Ylli i Danubit») nga Mihajl Kogëlničeanu, dhe e përkohëshmjja *România Literara* (Romania Letrare») nga Vasile Aleskandriu, ku bashkëpunuen Aleku Ruso, Grigore Aleksandresku, Dimitrie Bolintineanu, etj. Të dyja këto organe luftuen për bashkimin e princënivet. Poeti V. Aleksandriu, që ma vonë do të zgjidhet anëtar nderi i Kryesisë së shoqnisë shqiptare *Drita* të Bukureshtit, boton një koleksion poezish popullore rumune, mbledhë prej tij. Nis, kështu, mbledhja, botimi dhe studimi i letërsisë gojore në vend. Bolintineanu, që do të vijë ma vonë në Shqipëri dhe do të shkrujë motive poetike arumune e shqiptare, nxjerr në dritë disa gojëdhana historike; folkloristi Anton Pan ban të njohuna dy vepra popullore *Povestea vorbi* («Tregimi i fjalës») dhe *Nastradin Hoge*a. Për shkencën historike, Kogëlničeanu botoi në Jash të përkohëshmen *Arhiva Româneasca* me të cilën ndihmoi historianët në atdhe. Në këtë kohë nis punën shkencore dhe letrare Bogdan Petriçesku Hashdeu, i cili asht i pari dijetar rumun që merret me çështjen shqiptare dhe ban pjesë në kryesinë e nderit të *Dritës* shqiptare, bashkë me Aleksandriun, Joan Gjikën, etj. Ekonomisti dhe memorialisti i shquem Ioan Gjika, kushërinë i Elenës, nisi të nxjerrë *Convorbiri Economice*» (Bisedime ekonomike»). Në fushën e arteve, një zhvillim të mbarë morën muzika dhe piktura. Profesori i muzikës në Kolegjin e Shën Savës, I. Vahmani, nxori në Vjenë kangë popullore rumune. Koleksione melodish popullore rumune mblodhën e botuen edhe Flehtenmaheri e Budesku. George Asaki, pioneri i kulturës moldaviane, ishte edhe piktor amator. Bashkë me Natan Skiavonin (ndoshta i afërm i Felçe Skiavonit), ai

përfillet si nisëtar i pikturës së kohës në Moldavi. Në Vllahi u çfaqën piktorët I. Neguliçi dhe M. Lapati, që kishin studiue në Paris. I ndikuem nga romantikët, Lapati ekspozoi veprat e veta në Paris, më 1857. Bir tregëtar i me prejardhje shqiptare nga Krajova, Theodor Amani korri sukses në Paris me dy tabllo të veta, po më 1857. Këto ngjarje të shenueme në fushën e arësimit, kulturës, shkencës dhe arteve rumune nuk ishin të panjohtuna për Elena Gjickën. Njëpërmjet fijeve të ndryshme ajo lidhej me këto ngjarje, ku luejtën një rol të madh disa personalitete, që ishin ose të afërm ose të njohun mirë të Elenës sonë. Princi i Moldavisë Grigor Aleksandër Gjika, kajmekami i Vllahisë Aleksandër Gjika, dijetari Ioan Gjika, — të gjithë këta ishin të fisit të saj. Ajo, pa dyshim, ishte në dijeni të sukseseve të Lapatit dhe Amanit në Salonin e Parisit. Sidomos ajo njihte nga afër veprimtarinë e Asakit, pasi me bijën e tij ishte mike e ngushtë. Kjo bijë e Asakit u martue me Edgar Kinen, i cili, si do të shihet ma poshtë, u ba shok mendimi i Elenës. Ndoshta kjo njihte edhe veprën e Natan Skiavonit, aq ma tepër në pastë qenë ky i afërm i Felice Skiavonit, që jo vetëm i punoi asaj një portret, por edhe u frymëzue prej saj për punime artistike me motive historike shqiptare. Në rrethanën e mbledhjes së letërsisë gojore dhe të muzikës së popullit, në vrullin që morën letërsia e shkrueme dhe shkenca historike, — për të cilat ajo do të çfaqet me prirje të veçanta — Elena do të fillojë vetë të krijojë dhe të bahet shumë e njohun në Evropë.

Në Belgjikë ku nuk qëndroi veçse pak muej, ajo botoi studimin *La vie monastique dans l'église orientale* («Jeta murgare në kishën lindore»),¹⁾ ku përshkroi Kuvende të Vllahisë, Moldavisë, Maqedonisë, Thesalisë, Greqisë, Ruisë, Armenisë, Palestinës

dhe Egjiptit. Në 'të, ajo kundërshtoi jetën e mbyllët, skolastike dhe dogmatike, që çonin rregulltarët e Lindjes. Jetën murgare nuk e kish jetue vetë, por e kish pamë në shumë prej këtyne vendeve, kuvendet e të cilave ze në gojë, sidomos në Vllahi, Moldavi dhe Rusi. Këtë studim të guximshëm, me synim të qartë, pa fanatizëm sektar, ajo e kish përgatitë me kohë dhe, tashti, posa u largue nga Rusia, e hodhi në shtyp.

Nuk dihet se përse vajti në Bruksel, por, sidoqë të ketë qenë puna, grueja e re, e mbetun pa burrë dhe pa fëmijë, e rame nga shëndeti, nuk qëndroi aty veçse pak muej. U largue prej andej dhe vajti në Zvicër. Më 13 qershor 1855, e shohim t'i ngjitet ma së naltës maje të Monhut. Rreth këtij udhëtimi ajo botoi, një vit ma vonë, përshkrimin *La Suisse Allemande et l'ascension du Monch* («Zvicra gjermane dhe ngjitja në Monh»),²⁾ ku gjinden disa pamje të malit të njohun dhe dëshmitë e drejtuesit të ngjitjes atje. Nisi, kështu, një etapë e re e jetës së saj: etapa e shtegëtive dhe e krijimtarisë. Me shetitje nëpër botë, me punë krijuese, Elena po mbushte atë zbrasëti që i la martesë fatzezë. Prirjet e saja, që zunë të çfaqen heret në përvehtësimin e gjuhëve të hueja, në përdorimin e fjalës, të vijës dhe të ngjyrës, në studimin e së kaluemes dhe të së tashmes, në përshkrime të holla dhe të përpikta të mjedisit shoqëror dhe të natyrës, — prirjet e saja, pra, po çmohen nga ditë e ma shumë. Ajo nuk qëndron mospërfillëse ndaj vendlindjes së vet. Më 1857, pa i mbushë ende tridhjetë vjetët, si një kërkimtare e re, ajo nxjerr në dritë një vepër pionere përmbledhjen e letërsisë gojore të vendlindjes: *La littérature roumaine — chants et récits populaires* («Letërsia rumune — këngë dhe tregime popullore»), tue u radhitë me 'të krah për krah mbledhësve dhe studimtarëve te parë ru-

munë të krijimtarisë gojore — Vasile Aleksandriut, Anton Panit, etj. Fillonte, në këtë mënyrë, ajo punë e madhe e Elenës, e cila do të synojë me pohue, përmes letërsisë gojore, qenjen e kombësive të Evropës jugë lindore. Përngjat kësaj veprë së parë me këtë karakter, ajo botoi për vendlindjen rumune, në *Diritto të Torinos* dhe gjetiu, disa artikuj aktualiteti, si: *Vëzhgime rreth organizimit të princënivet danubiane*, — *Rreth vëllaznisë së popujve latinë dhe rreth veprës së tyne për qytetnim të njerëzimit*, — *Një princ i huej në Molda-Vllahi*, — *Propaganda austriake në princënitë danubiane*, etj.

Në rrjedhim të shtegëttimeve të shpeshta dhe të largta, ajo qiti në dritë një tok mbresash udhëtimi nëpër organe të ndryshme shtypi, si, p.sh., te *Illustration* i Parisit, *Le jour*, i Trieshtës, etj. Mbresa të njohuna udhëtimi u banë: «Kujtime të zonjës Dora d'Istria — Ngjitja në San Salvador» «Një verë në breg të Danubit», «Ishujt Jonianë», më 1858, si dhe kallëzimet: «Në breg të liqenjve helvecianë», të cilat P. Mantegaca i vlerësoi shumë, tue shkruar:

«...dy diamanta psikologjie të shkallës së parë, ku, pa u lëshue ndër katastrofa dramatike ase në të dhanë hov të tepruem ndiesive, ajo (autorja, V.B.) len zgjuet vërejtjen tonë, na prek mu në zemër». ³⁾

Duket qartë nga të gjitha këto, se Elena jonë gjatë pesë vjetvet, në periudhën 1855-1859, kaloi nga Rusia në Belgjikë, në Zvicër, në brigje të Danubit, në ishuj Jonianë, iu ngjit majave Monh dhe San-Salvador. Në këtë periudhë, tek doli me botimet e para letrare e kërkime dokumentare, përdori edhe pseudonimin Dora d'Istria, të cilin do ta mbajë deri

në fundin e jetës së vet dhe do ta mbulojë me lavdi.

Po nga vjen ky pseudonim? Ç'kuptim ka? Vështri-rë të përcaktohet. 4) Sido që të jetë kjo punë, Elena Gjika u pagëzue me një emën të ri: princesha ja lëshoi vendin shtegtares, studimtares, mendimtares, artistes, dijetares. Nëpër qendra të ndryshme evropiane, ky emën i ri do të përmendet, tash e tutje, me një nderim të veçantë, tue u rrethue me një pëlhu-rëzë mithi dhe tue u kunorëzue me një keze zulme. Kush asht Dora d'Istria? nga vjen ajo? Cilit atdhe i përket?

1. Dora e parë u shtyp në Bruksel, më 1855; e dyta, në Paris dhe Gjenevë, te Cherbuliez, më 1858.

2. Dora e parë u shtyp në Paris dhe Gjenevë, te Cherbuliez, më 1856; u përkthye në anglishte nga Hume Greenfield, Londër — Edinburg; në gjermanishte nga Meyer dhe Zeller (1857-1859) me titull *Die Detusche Schweiz*, tue pasë pranë si shtojcë, një kapitull të ri (LXXVIII: Napoleon III im der Schweiz) përkthye nga prof. dr. Heinrich Kurtz, historian i letërsisë gjermane.

3. sp. Fishta F.: *Dora d'Istria*, në *Shkëndija*, viti II, Nr. 7-8, Tiranë, 1942, f. 248.

4. Dora d'Istria asht një sajim, që duket se i shkon ma shumë italishtes. Po të jetë kështu, atëhere *Dora*, në italishte, spjegohet nga emni i vjetër *Duria* (lat. *Duria Maior* dhe *Duria Minor* në Piemont); në dialektin piemontez, *doira* don të thotë «corso d'acqua» («rrjedhë uji»), fr. *doire*. Istria, e lagun nga Adriatiku, lidhet me istrorumunet, imigrue aty në shekullin XVI, Në shekullin XVI, Venetia i dha dorë imigrimit të të huejve aty, sidomos popullëstive ballkanike të largueme nga viset e lindjes për shkak të dyndjes së turqve.

Ndër këto popullësi të ardhuna në Istria qenë edhe mjaft shqiptarë.

Në kuptimin e parë, tue u nisë nga spjegimi i masipërmë, Dora d'Istria don të thotë Dora e Istrias. Mirëpo, përveç këtij vështrimi, mund të mendohet edhe ndonjë tjetër kuptim. Eftim Mitkua, kur do t'ja kushtojë poezinë hymnizuese më 1869, do ta quejë *Dorë Istriade*, tue ja shqiptarizue emnin Dora në Dorë dhe tue ja kthye pjesën tjetër të pseudonimit nga Istria në Istriade, pas shumë gjase në fytyrën e Histrias, qytezës, afër bregut të Detit të Zi, për anë Konstancës që njihej lashtazi me emnin Tomis.

Për sa i takon emnit Dora mund të mendohet, përveç Doria-s që përmendëm ma sipër, ose *Dorade* (lloj peshku i përraruem), ose *Doris* (bija e oqeanit dhe e Tethysit, ama e Nereideve).

KAPITULLI I TRETË

MPROJTËSE E FLAKTË E LIRISË SË KOMBËSIVE

«Motër heroike...»

Garibaldi

Jetonte dhe krijonte në atë kohë një poet, filozof dhe historian i shquem freng, — Edgar Kiné, i njohur për veprat *Ahasvérus* dhe *Revolution*, mprojtës i flaktë i lirisë së kombësive. Ky mendimtar dhe luftëtar politik ishte njëzet e pesë vjet ma i moshuem se Elena Gjika. Një miqësi e madhe i lidhi këta të dy, jo vetëm sepse Edgar Kiné mori për grue bijën e George Asakit, shoqen e Elenës, por sepse që të dy kishin thuejse të njajtat pikëpamje rreth shumë çështjeve të shoqënisë së kohës. Këto lidhje miqësore dhe pikëpamje të përbashkëta i ka studiue e qitë në dritë I. Breazu.¹⁾ Nuk mund të mos theksohet këtu se, porsi Kiné, edhe Dora d'Istria ishte ndjekëse e krishtënimit evangjelic, ma shumë protestant se sa ortodoks, kurse, në politikë, ithtare e parimit të lirisë së kombeve të mëdha e të vogla, pa dallim.

«Na nuk durojmë as papën, as perandorin»²⁾

u ba shprehja e saj e njohun .

Më 15 mars të vitit 1859, Dora botoi në të përkohëshmen e famëshme të Parisit *Revue des deux Mondes* studimin *La nationalité roumaine d'après les chants populaires* («Kombësia rumune sipas këngëve popullore»), tue nisë serinë e artikujve të bujëshëm, tek ai organ, rreth pohimit të kombësive të Europës jugë lindore përmes këngëve të popujve përkatës. Gjatë katërmbëdhjetë vjetvet, që nga 1859 deri më 1873, Dora botoi në të përkohëshmen frenge shtatë artikuj të tillë rreth kombësive rumune, serbe, shqiptare, helenike, bullgare, si dhe rreth poezisë popullore të maxharëve dhe turqve lindorë. Seria e këtyne punimevet dëshmonte se ajo ishte një njohëse e rrallë e kombësive dhe e poezisë së popujve të Evropës jugë lindore, një mprojtëse e flaktë e lirisë së tyne.

Interesimin për kombësinë dhe poezinë shqiptare, Dora d'Istria e tregoi përpara 15 majit 1866, datë në të cilën boton artikullin për 'to në të përkohëshmen e përmendun pariziane. Pikërisht më 10 nanduer 1859, ajo i dërgon nga Zvicra një letër poetit tonë të shquem arbëresh, Jeronim De Radës. Letërkëmbimi midis Dorës dhe De Radës asht një pjesë e letërkëmbimit të saj me dijetarë, artistë dhe personalitete të tjera në za të Evropës dhe Amerikës në periudhën 1855-1888, si dhe me atdhetarë shqiptarë të kolonive shqiptare a të atdheut, p.sh. me Dhimitër Kamardën, Zef Seremben, Leonardo De Martinon, Zef Jubanin, Eftim Mitkon, etj. Një pjesë e letërkëmbimit të saj u nxuer në dritë nga dijetari N. Jorga, ³⁾ kurse letrat e saja dërgue poetit tonë të Makjit gjinden në Arkivin e Shtetit Shqiptar. ⁴⁾ Janë gjithsejt 109 letra, shkrue të gjitha frengjisht, me dorë, në grafi të pastër dhe të qartë. Kur filloi letërkëmbimi me poetin e Makjit, Dora ishte tridhjetëvjeçare, kur-

se De Rada dyzet e pesë. Zgjati këmbimi i letrave afro tridhjetë vjet. Një vit pasi i dërgoi De Radës letrën e parë që njohim, Dora shkroi e botoi veprën *Les femmes en Orient* («Gratë në Lindje», Zurih, 1860), në vëllimin e parë të së cilës, si do ta shohim ma poshtë, ajo do të vlerësojë me të madhe dashurinë e shqiptarëve për liri.

Po cilat qenë ngjarjet kryesore, që ndodhën në periudhën midis 1859-ës, kur ajo çfaqti së pari interesimin për çështjen shqiptare, dhe 1866-ës, kur ajo nxori në dritë artikullin rreth kombësisë shqiptare sipas kangëve popullore?

Në Shqipni, pas shpartallimit të princënivet të mëdha feudale të veriut dhe të jugut, qëndresa e popullit shqiptar nuk u shue. Shpallja e Tanzimatit, që u ndërmuar nga përfaqësuesit ma tejpamës të klasës feudale turke për ta drejtue Turqinë në rrugën e zhvillimit kapitalist, solli shtimin e lëvizjes kombëtare të popujve të shtypun të perandorisë osmane. Në çerekun e dytë të shekullit XIX u ndezën disa kryengritje fshatare shqiptare. Mendimet e lëvizjes kombëtare po përhapeshin nga ditë e ma shumë në kolonitë arbëneshë dhe në atdhe. Pjesëmarrja e shqiptarëve në kryengritjen e vitit 1821 në Ballkan, radhitja e arbëneshëve të Italisë në vijën e parë të luftës së popullit italian kundër burbonëve dhe austriakëve pushtues, si dhe në lëvizjen për bashkimin e Italisë e në atë garibaldine, tregojnë lidhjen e çështjes shqiptare me çështjen e çlirimit të popujve të tjerë fqinj. Lëvizja kulturore shqiptare, që pararendi dhe shoqënoi kryengritjet e herëpashërëshme, shënoi me të vërtetë një përparim në vitet '60 të shekullit XIX, sidomos në terrenin arbënesh të Italisë. Një rol të madh për popullarizimin

e çështjes shqiptare luejti pjesëmarrja e gjallë e arbëneshëve në lëvizjen kombëtare italiane. Krahas kësaj përpjekje, u dukën edhe veprat e para arbëneshë në fushën e mbledhjes së letërsisë arbëneshë dhe të studimeve të gjuhës, pasi kjo kish nisë të lërohej me shkrime fetare dhe artistike. Engjëll Mashi, Zef Krispi, Gjon Sqiroi mprojtën pikëpamjen e lidhjeve gjuhësore të shqipes me pellasgjishten dhe të prejardhjes së saj nga pellasgjishtja. Kësaj iu përmbajt pastaj De Rada, vetë Dora d'Istria dhe shumica e mendimtarëve të Rilindjes sonë. Më 1847, Vinçenc Dorsa botoi veprën *Sugli albanesi, ricerche e pensieri* («Rreth shqiptarëve, kërkime dhe mendime»), që ngërthente të dhana rreth historisë së Shqipënisë, kolonive arbëneshë, etnografisë, letërsisë gojore arbëneshë; më 1864, Dhimitër Kamarda nxori në dritë *Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese* («Provë gramatologjie të krahasueme të gjuhës shqipe»). Këto vepra, si dhe ato të De Radës — *Milosaat, Principi di estetica* («Parime të estetikës») e, sidomos, *Rapsodie d'un poema albanese* («Rapsodi të një poemi arbënesh») — ngjallën interes përpara opinionit publik. Emni i De Radës u ba shumë i njohun, jo vetëm në botën letrare arbëneshë, por edhe jashtë saj, në Itali e gjetiu. Në radhën e admiruesvet dhe miqvet të tij, përveç gjuhëtarit gjerman T. Shtier, historianëve italianë C. Kantù dhe N. Tomazeo, poetëve frengj A. de Lamartin dhe F. Mistral poeteshës austriake J. de Knorr, ishte edhe Dora d'Istria. Një hov të dukshëm morën studimet e dijetarëve të huej rreth shqipes dhe shqiptarëve, si ato të Tunmanit, Bopit, Hahnit, Kzilanderit, Shtierit, Shlajherit, Askolit, Hashdeut, etj.

Në këto rrethana historike, politike dhe kulturore, Dora d'Istria sillet e merret me çështjen shqip-



Jeronim De Rada

tare. Mirëpo ajo ishte ngulë në Itali, ku atmosfera e lëvizjes çlirimtare po tërhiqte forca të njohuna të përparimit. Më 1861, u arrit bashkimi i Italisë, por ky bashkim u krye plotësisht më 1871. Në luftën për bashkim, arbëneshët qenë, si e thamë një herë, mbështetje e fuqishme e Xhuzepe Garibaldit në Siqeli dhe Kalabri. Veç, në vend të republikës së dëshiruar, çifligarët liberalë dhe borgjezia e madhe vunë në fuqi monarkinë.

Ndërkohë, në vendlindjen e Dorës, në Rumani, pas bashkimit të princënivet dhe sajimit të shtetit të vetëm rumun, për drejtimin e maqinës shtetënore qëndronin ballëpërballë bujerësia dhe borgjezia. Nga 11 tetori i vitit 1859 deri më 30 prill 1860, në krye të qeverisë erdhi kushërini i Dorës, Ioan Gjika. Bujerët donin të ruenin me çdo kusht paradrejtat. Tash e parë hypin e zdrypin qeveri të një krahu a të një tjetri. Më 1861, vihet në krye të kabinetit qeveritar Dhimitër Gjika, i partisë konservatore. Kundër krahut përparimtar të vendit u ngrit besëlidhja e përbindëshme dhe përbetuese e bujero-borgjezisë. Në këtë mes Gjikajt u ndanë më dysh: Ioani mori anën liberale, kurse Dhimitri anën konservatore. Bujkrobnia u shprish. Por krahu përparimtar nuk qëndroi dot në fuqi, sepse përbetimi bujero-borgjez, më 10 shkurt 1866, e rrëzoi me dhunë princin e zgjedhun të vendit Aleksandër Ion Kuzën, dhe fronin e Rumanisë ja dorëzoi një princi të huej. Ndoshta kjo gja e ftohu Elena Gjiken ndaj vendlindjes dhe e lidhi përgjithnjë me vendin e të parëvet, Shqipninë. Nuk vajti ma në Vllahi dhe Moldavi, nuk u muer ma, si pak vjet ma parë, me popullarizimin e çështjes rumune, por lidhjet me lëvizjen diturake, kulturore dhe artistike rumune nuk i preu. Me vemendje ndoqi ajo disa ngjarje të shenueme në fushën e kulturës

dhe të dijes. Në vitet 1861 dhe 1863, u botue *Re-
vista Română*. Mbrenda vitevet 1864-1865, B.P. Ha-
shdeu drejtoi *Arhiva istorică a României* («Arkiva
historike e Rumanisë»), tek e cila botoi dokumenta të
randësishme në lidhje me historinë e vendit. Papiu
Ilariani nxori, midis vitevet 1862-1865, tri vëllimet e
mëdha nga *Tezaurul de monumente istorice* («Thesari
i përmendoreve historike»), me tekste dhe përkthime
të historianëve dhe udhëtarëve të huej të shekujve
XVI dhe XVII, në lidhje me rumunët. Më 1862, në Bu-
kuresht, u themelue *Shoqata e Shkencave*. Mjeku
Turnesku inauguroi, më 1 shtator 1865, Muzeun e
antikiteteve, bazën e të cilit e përbanin ato që kishte
mbledhë i ati i Elenës, Mihajl Gjika.

Në rrjedhën e këtyne ndodhive (të atdheut të të
parëve të vet) të vendit ku u ngul dhe ku ish lindë,
Dora d'Istria krijoi një radhë veprash, që ja shtuen
famën në Evropë dhe që i sollën një kontribut të
shquem çështjes së popujve të Evropës jugëlidore,
veçanërisht asaj shqiptare. Më 1860, si e thamë ma
sipër, ajo botoi *Les femmes en Orient* («Gratë në
Lindje»), tek e cila, midis faqevet 267-341 të librit
IV, flet për shqiptarët, tue i përfillë si bij kreshnikë
të një race, që ka ruejtë trashëgiminë dhe nuk asht
prishë asnjë herë.

«*Liria, thonë fatosat e Sulit në përsëritjen e një
kange që e kanë aq fort për zemër, ka qenë kurdoherë
bija e ngadhëngjimit*».

shkruen ajo në faqen 307 të kësaj vepre.⁵⁾

Më 28 maj 1860, në shenjë vlerësimi, Shoqata
Arqeologjike e Athinës e zgjodhi anëtare nderi.

Më 16 korrik 1861, Xh. Garibaldi i dërgoi një
letër, në të cilën midis të tjerash, i shkruente:

«Unë shpresoj pa masë në ndikimin tuej të naltë mbi bashkatdhetarët tuej» 6).

tue kërkue, kështu, përkrahjen e saj në lidhje me arbëneshët e Italisë.

Ndërkohë, ajo ndërmori udhëtime nëpër Rumeli dhe More, nga të cilat doli vepra *Excursions en Roumélie et en Morée* («Eskursionë në Rumeli dhe në Morë»), botue kryepari në Zurih, më 1863. Janë përshkrime të matuna, mësimë të vërteta historie dhe gjeografie. Në parathanien e kësaj vepre autorja shkruen:

«Ndërsa vijonte qëndrimi im në Greqi, u vuna përmbi të gjitha të mbledh ma tepër ore se sa të paraqes teori. E shtyme nga një dëshirë e posaçme që të jem e paanëshme, i kam vështruar njerëzit e të gjitha rrymavet; kam studiue të gjitha klasat dhe kam pyetë, me të njajtën dashuni, si barijtë e dhive të Parnasit e të Arkadisë, si fanariotët, profesorët dhe teologët e Athinës.» 7)

Në shenjë mirënjohjeje për këtë vepër, si dhe për sa e sa punime të tjera të kësaj natyre, ajo mirëpritëte në Greqi me nderime të mëdha. Dhoma e deputetëve, njëzani, i dha nënshtetësinë e nderit, vlerësim ky që i bahej për të parën herë një grueje së huej.

Më 15 janar 1865, në vazhdim të studimit të kombësive të Evropës jugë lindore sipas kangëve popullore, ajo botoi te e përkohëshmjia pariziane *Revue des deux mondes* artikullin «*La nationalité serbe d'après les chants populaires*» («Kombësia serbe sipas kangëve popullore»).

Po këtë vit, Dora D'Istria nxori në dritë një ve-
për të re të quejtun *Des femmes par une femme* ⁸⁾
(«Gra të shikueme nga një grue»), ku çfaqi adhuri-
min, ndër të tjera, për kreshnikinë e Zhanë d'Arkës
dhe për qëndresën burrnore të Venetisë.

Më 21 mars 1865, nga Villa Kaprili të Ardencës
së Livornos, ajo i dërgoi një letër De-Radës, në të
cilën i thoshte këto:

«Due të mendoj se ju do të gjeni prova të reja
në historinë e princëve Gjika për të cilët duhet të
ju ketë ramë në dorë materiali që ju dërgova dhe me
postë. Asht për t'u shenue në të vërtetë se midis
popullsivet të dobësue me të Italisë lindore — mund t'i
jepet mirëfilli ky emën Rumanisë — sovranët e racës
sonë, që nga Vasil Shqiptari deri tek Grigori III Gjika
i Moldavisë dhe Grigori IV Gjika i Vllahisë, kanë çfa-
që gjithë energjinë e të parëve tanë. Mb'anë tjetër,
në Stamboll, sikurse në brigjet e Nilit, vezirët e më-
dhej shqiptarë dhe familja e Mehmet-Aliut tregonin
se veprimi idhnak i Islamit nuk kishte vend për t'u
derdhë mbi njerëzit tanë. Këto fakte shkëndëritëse
duhet të na mbushin me shpresë për të ardhmen e
Shqipnisë. Që nga fillimi i shekullit toka amëtare
e Skanderbegut ka nxjerrë një legjion trimash dhe
kreshnikësh: Xhavellët, Grivasët, Boçarët, Moskot,
Dhespot. Kam rigjetë në udhëtimin tim të fundit në
Lindje (Ballkan, V. B.) njanën nga bijat e kreshnikut
Marko, dhe kam vizitue në Specja shtëpinë e familjes
së Bubulinës. Tue vu lule në Mesolongji, mbi varrin
e Boçarit, iu luta Qiellit që të shoh një ditë mbi va-
rrin e të madhit Kastriot tue valëvit flamurin që ai
ka mprojtë plot zulmë në njëqind luftime. U për-
mbushtë kjo dëshirë!» ⁹⁾

Më 19 janar 1866, Shoqata Gjeografike e Fran-
cës, e zgjodhi anëtare nderi. Më 15 maj 1866, në të

përkohëshmen *Revue des deux mondes* Dora d'Istria botoi artikullin e famëshëm *La nationalité albanaise d'après les chants populaires — Les albanais des deux côtés de l'Adriatique* («Kombësia shqiptare sipas këngëve të popullorë — Shqiptarët e të dyja anëvet të Adriatikut»). Këtë e botoi, pra, pasi kishte nisë letrëkëmbimin me De Radën (1859), pasi kishte vlerësuar, në *Les femmes en Orient* (1860), kreshnikinë shqiptare, pasi Garibaldi i kishte kërkue që të përdorte ndikimin e saj mbi bashkatdhetarët arbëneshë në luftën e çlirimit kombtar në Itali (1861), mbasi i kishte mburrë De Radës, në letrën që cituem ma sipër (1865), çfaqjen e energjisë shqiptare nëpër botë. Artikulli u përkthye menjëherë italisht nga E. Artomi, greqisht nga Therianos — prift i kishës lindore të Trieshtës dhe Drejtor i shkollave helenike në Kretë — arbënisht nga Dh. Kamarda. Ky artikull, si e thamë ma sipër, bante pjesë në kuadrin e një cikli artikujsh që ajo botonte në të përkohëshmen frenge dhe që merreshin me pohimin e kombësive të Evropës jugë lindore përmes poezisë së tyne gojore. Ajo kishte për qëllim të argumentonte në këtë artikull qenien e kombësisë sonë, lashtësinë e popullit shqiptar, trashigimet e tij kulturore-artistike, të çmonte gjuhën e lashtë e të bukur shqipe, letërsinë tonë të pasun gojore. Si rrjedhim, populli shqiptar, një nga ma të vjetrit e Evropës, meritonte të ishte i lirë dhe në liri t'i zhvillonte ma tej aftësitë e veta krijuese.

«Dashunia për atdhe ka qenë gjithmonë veçoria ma kryesore e shqiptarit. Shqipnia ndër të gjitha kohët ka qenë vendi i herojve. Kombi shqiptar asht një popull i fortë, i fuqishëm porsì shkambijtë ku jeton. Shqiptarët janë të gjallë,

të gëzueshëm, punëtorë dhe zemërbardhë. Kur asht puna për t'i dalë zot atdheut të vet ase për të mprojtë fëmijët e vet, ai asht hero në kuptimin e ngushtë të fjalës. Popullt shqiptar ka qitë ushtarë e luftëtarë, që kanë mrekullue botën me trimnitë e tyne, si Pirrua, Aleksandri i Madh, Diokleciani, Skanderbeu, etj. Me plot të drejtë Bajroni pat shkruar mbi heroizmin e tyne. Vetëmohimi dhe flija e tyne qenë ndihma ma e madhe në kryengritjen greke për çlirim. Mbi shkambijtë e Sulit dhe mbi zallin e Pargës gjinden ende tepricat e një populli, që dha jetën e vet për pavarësinë greke. Atje ndodhen dhe gjurmët e gjakut të martirëve shqiptarë». ¹⁰⁾

Dhe ma tutje, me optimizëm për të ardhmen e Shqipnisë, ajo vazhdon:

«Në një gjendje të tillë, a asht e mundun me besue se shqiptarët do të mbeten edhe për një kohë të gjatë nën thundrën e sundimit të huej?... Ata, që e besojnë këtë gja, harrojnë se kombi shqiptar asht një komb herojsh, ashtu siç e përshkruajnë njëzani ata që e kanë studiue me kujdes, anglezë, frengë, udhëtarë a historishkrues, Gellët, Douglasët. Lamartinët». ¹¹⁾

Me këto argumente i drejtohej ajo opinionit publik evropian për ta nxitë që ta njihte dhe ta përkrahte çështjen shqiptare. Njëkohësisht, këto argumente u banë një shtytje e fortë për studimtarë dhe atdhetarë, që të merreshin me popullarizimin e së drejtës së popullit tonë për liri dhe mvehtësi. Kështu spieghohet fakti që artikulli në fjalë bani bujë të madhe. Ishte një rasë e volitëshme për t'u

vlerësue në mënyrë të veçantë: një princeshë me prejardhje të vjetër shqiptare, dijetare dhe artiste kaq e njohun në botën e qytetnueme, po i dilte zot popullit të vogël shqiptar. Pas veprës së Vinçenc Dorsës, Dh. Kamardës dhe J. De Radës deri atëhere, kjo e Dora d'Istrias përbante një burim dhe ishte një frymëzim për njohjen e vlerave shumë të çmueshme morale të popullit tonë.

Nga Villa Kaprili e Livornos, më 14 qershor 1866, ajo i shkruen De Radës:

«Një popull si ky yni nuk do të shkatërrohet dhe due të besoj se na nuk do të vdesim para se ta shohim atdheun të lirë prej zgjedhës së barbarëvet».

Ajo, tashma, asht ngulë përgjithnjë në Itali. Çështja shqiptare nis e ze vendin kryesor në ato që i interesojnë asaj. Më 19 korrik 1866, i shkruen De Radës:

«... Ju keni arësye të mendoni se asht diçka thelbësore që të mos nxitohet në Shqipni. Gjaja e parë për t'u bamë asht që të zgjohet në kombin ndenja e bashkimit të tij. Sa kohë që kjo ndjenjë nuk asht zhvillue plotësisht, nuk duhet ndërmarrë asgja përfundimtare, ndryshe shqiptarët do të shfrytëzoheshin nga interesa që për 'ta janë mjaft të hueja. Trimnia e tyne u jep të drejtën me luejtë rolin e parë në gadishullin lindor. Por fryma e fisit, ma e fortë ende se fryma kombtare, do t'i ekspozonte më iluzione të rrezikshme po qe se, para se me fillue luftën e egër, nuk do të harronin që Gega dhe Toska, bij të të njëjtit atdhe, duhet të lënë më njanë luftat e tyne shekullore, për të sigurue pavarësinë e vet».

Dhe, më 6 shtator 1866, nga Livorno, ajo i tregon De Radës se ç'dobi sjell bashkëpunimi nëpër organe, që ndikonin për mirë në opinionin publik të kohës; e lajmëron me gëzim për jehonën që po linte vepra e saj rreth kombësisë shqiptare sipas poezisë gojore dhe i çfaq mendimin për gërshtimin e mbështetjes në forcat e veta kombtare me faktorët e jashtëm:

«Studimi im mbi shqiptarët asht përmbledhë tash vonë në ma populloren e përmbledhjevet të Gjermanisë, Illustrirte Zeitung të Lajpcigut. Po shoh me kënaqësi se çeshtja shqiptare po merr udhë me të shpejtë... Mb'anë tjetër, kini mirësinë me përfillë, se të gjitha kombësitë kanë pasë nevojë në fillim për një pikëmbështetje të jashtme. Mjafton me çekë Shtetet e Bashkueme, Greqinë, Belgjikën, Italinë. Nuk duhet aspak me u lanë që të thithemi; — por nuk duhet gjithashtu me u veçue sistematikisht».


Më 21 shtator 1866, përsëri nga Livorno, ajo i ritheskon poetit të Makjit pritjen e mirë që ka gjetë në publikun e huej vepra e saj rreth kombësisë shqiptare:

»...Për sa më lejon largësia të gjykoj, La Nationalité Albanaise ka përfutue një mbresë fort të mirë. Kjo gja mund të shihet tashma nga artikulli i popullores Illustrirte Zeitung se gjermanët po shohin tekembramja që një rol fort i rëndësishëm u asht ruejtë shqiptarëvet në Lindje (Ballkan, V. B.)».

Ajo asht ngulë në Livorno, në Villa Kaprili — Ardenca, që nga marsi 1865 deri më nandor 1866;



Ioan Gjika



pastaj, nga dhjetori 1866 deri më prill 1869, e shohim në Veneti, në Palazzo Foskolo, Gran Kanale; kurse në gusht 1869 në Pelji, krahinë e Gjenovës, më tetor 1869 në Torino, Piacca delo Statuto Nr. 11, më shtator e tetor 1870 në Rapalo, krahinë e Gjenovës dhe, që nga pranëvera e vitit 1871 deri më 1888, d.m.th. deri sa mbylli sytë u ngul përgjithnjë në Firenze, tue u largue prej saj vetëm përkohësisht, për pushime verore e dimnore dhe për arsye kërkimesh dokumentare.

Tue vazhdue me ndjekë interesimin e saj përcështjen e çlirimit tonë kombëtar, nuk mund të mos nënvizojmë prapë bashkëveprimin e saj me luftëtarin e shquem të popullit italian, Xhuzepe Garibaldin. Më 13 tetor 1866, ajo i ban fjalë De Radës për një letër të gjeneral Garibaldit:

«...lidhë me ngjarjet që po ndodhin tashti në gadishullin lindor. Kjo letër — vazhdon ajo — asht një përgjegje një tjetre në të cilën unë i spiegoja arësytet e forta që Italjanët kishin për t'u radhitë në anën e mprojtësve të kombësisë shqiptare. Po jua dërgoj letrën e gjeneralit për rasën që ta gjeni të volitëshme me e përcjellë në Shqipni dhe me e botue në një fletore të Kalabrisë».

Dora d'Istria mendonte atëhere se ishte koha ma e përshtatëshme për kryengritjen e kombësive në Evropën jugë lindore. Në letrën e 15 tetorit 1866, ajo i shkruen De Radës për shumë detyra, që dilnin në lidhje me çështjen shqiptare. Ajo i thotë aty:

«...Koha asht e volitëshme për kryengritjen e kombësive. Në fillim të shekullit, Serbia i dëboi turqtë. Në vitet e para të qënies sime, kam

pamë Greqinë tue dalë nga varri. Ka nja dhjetë vjet, Rumania, së cilës unë e vetme ja mprojta të drejtat, asht rikthye në komb. Përse Shqipnia, trimnia e së cilës asht e pashoqe, të ketë një fat ma të keq?...»

Pastaj, ajo thekson përsëri nevojën e shmangëjes së ndasisë fetare dhe krahinore, nevojën e zgjimit dhe bashkimit kombtar:

«...I vetmi mjet për të ngadhënjye mbi këtë vështirësi (mbi ndasinë fetare dhe krahinore, V. B.) asht me zgjue në shpirtnat e njerëzvet ndjenjën e bashkimit kombtar...»

Ajo e këshillon De Radën që ta nxjerrë fletoren, për të cilën poeti i Makjit i kishte dërgue planin dhe programin. Ajo i propozon që këtë fletore poeti ta botojë afër gegënisë, p.sh., në Kotorr, në mënyrë që të përdoret si mjet lidhjeje midis lëvizjes atdhetare shqiptare të vendit dhe asaj jashtë vendit.

«Se cili duhet të jetë vendi i botimit nuk asht e vetmja çështje që duhet rregullue, — vazhdon ajo në letër. — Do të duhej, gjithashtu, më duket, me u marrë vesh për gjuhën dhe për karakteret e shkronjavet. S'ka shkue shumë kohë kur ndër Sllavët e Jugut mbretënonte një përshtjellim i madh, qoftë për gjuhën, qoftë për shkrimin. Ndryshimi i dialekteve shqiptare asht mjaft larg për të na dhanë idenë e anarkisë së atij përshtjellimi. Përshtjellimi në fjalë nuk reshti, veçse kur shumë dijetarë atdhetarë u morën vesh për të vendosë një farë uniteti që u lejoi atyre popujve me kuptue njani tjetrin

dhe me ndihmë shoku shokun kundër vërshimit të gjermanizimit. Në Rumani, një revolucion i ngjashëm asht përmbushë në kohën tonë, nëpërmjet mënjanimit të fjalëve turke dhe sllave të gjuhës kombëtare dhe nëpërmjet zvendësimit të shkronjave cirilike të sllavëve me shkronja latine. Se ç'duhet të bajnë shqiptarët do të dukej fare e pamundun, po të mos dinim që diçka e tillë asht krye nga sllavët e jugut dhe nga rumunët — pamvarësisht prej pengesave politike, për të cilat do të shtyeshim gjatë me dhanë një ide. Përfytyroni, për të mos zanë në gojë veçse një fakt, po që se Rusia do ta kish pamë me kënaqësi vendosjen e latinizmit që kryehet në kufitë e saja nga Elia-de (Rëdulesku, V. B.) dhe bashkëpunëtorët e këtij. Përkundrazi Turqia e plogësht, e paaftë me kuptue randësinë e çështjeve të tilla, nuk ka me pasë asnjë kujdes ndaj përpjekjeve që kanë me bamë shqiptarët për të sajue unitetin e tyre intelektual, shkencor dhe moral, bazë e unitetit politik. Por ata që do ta kryejnë këtë vepër do të kenë hjedhë themelet e pashkatërrueshme të Shqipërisë së ardhme».

Ajo vlerëson këtu rolin e letërsisë në lëvizjen kombëtare. Sipas saj, çdo lëvizje e përtëritjes politike duhet të jetë e prime medoemos nga një lëvizje letrare:

«...çdo lëvizje e madhe përtëritjeje politike duhet të jetë e prime doemos nga një lëvizje letrare. Në Greqi, Rigasët dhe Korajët kanë qënë pararoja e Kanarisve dhe e Karajkasqive».

Dhe, për sa i përket alfabetit, ajo shpreh pëlqimin për alfabetin latin, në mënyrë që kështu shqipëtarët të prirën drejt qytetnimit perëndimor të kohës:

«...Po të guxoja, Zotni, me shprehë një mendim mbi çështje mjaft të huej për studimet e mia të zakonshme, unë do të kisha qenë e mëndjes me përshtatë plotësisht shkronjat latine».

Tue marrë prap fjalën për fletoren që De Rada dëshëronte të nxirrte, ajo propozon që kjo të emërtohej «*Flamuri i Skanderbegut*»:

«*Emni popullor e zulmëmadh i Skanderbegut do të provonte se të gjithë duhet të vendosin me vu interesin e atdheut shqiptar përmbi të gjitha farët e konsideratave ...Me ta pamë Papas Kamardën, do t'i flas për fletoren tonë dhe nuk dyshoj për bashkëpunimin e tij të gjallë*».

Dihet se, ma vonë, De Rada vërtet nxori një organ, por propozimin e Dorës për titullin e ndoqi pjesërisht: ai e quejti të përkohëshmen *Fiamuri Arbrit*. Më 8 nandor 1866 ajo i shkruen përsëri autorit të Milosaat-it. Me sa duket, poeti e kishte vonue përgjegjen e një letre të saj, sepse kishte qenë i zanë me punë bujqësore (ai punonte në arë). Dora zen fill nga kjo dhe e çmon nalt punën prodhuese në fushën e bujqësisë:

«*Ju keni veprue fort mirë që nuk i keni lanë punët në fusha për të më shkruë. Asnjëri*

nuk e kupton ma mirë se unë dobinë e pashoqe të këtyne punëve. Ditën kur Shqipnia jonë do të ketë aq bujq sa ka ushtarë, ajo do të jetë vendi i parë i Lindjes (Ballkanit, V. B.). Çdo komb, që don të jetë i fuqishëm dhe i madh, ka nevojë të ketë Çinçinatë, dhe i madhi Uashington asht kthye në fushat e veta pasi ka themelue ma të lulëzueimin e Shteteve të botës së re».

Ajo vazhdon t'i shkruajë këtu poetit rreth vështirësive që do të dilnin në fillim për leximin e shkronjave latine nga shqiptarët; por, shton, këto vështirësi do të kapërxehen, ashtu siç u kapërxyen nga rumunët pas shembullit të Eliade Rëduleskut:

«Më kujtohet fort mirë që kjo vështirësi i doli përpara Eliades, poetit të famshëm vllah, kur ky, i mbështetur nga im atë, i çliroi rumunët prej shkronjave sllave cirilike dhe ngadhënjëu në këtë punë për mrekulli».

Në qerthullin e çështjeve të ndryshme, ajo prek këtu edhe atë të botimit të një fjalori shqip ma të plotë se deri atëhere, në mënyrë që t'u vinte në ndihmë albanologëvet dhe vetë shqiptarëvet, nevojat intelektuale të të cilëvet po shtoheshin nga ditë e ma shumë:

«Nga një koinçidencë e rasës, unë po kryeja kërkime rreth fjalorëve shqiptarë gjatë kohës që ju po mirrëshit me të drejtë me detyrën për të punue mbi një leksik shqip. Kërkimet e mia, bamë njëkohësisht në Paris dhe në Vjenë, më kanë bindë për nevojën e një botimi që të jetë

ma i mirë se Fjalori i Propagandës (Fjalori latinisht-shqip i Frang Bardhit, V. B.) dhe katalogët e fjalëve të mbledhuna nga Ksilanderi, Liku, Pukëvili, etj. që të jetë në gjendje me lehtësue kërkimet e albanologëve dhe me u shërbye nevojat intelektuale — çdo ditë ma të madhe — të shqiptarëve».

Dora d'Istria i thotë në vazhdim De Radës, se kur do të çlirohej Shqipnia nga turqtë, muslimanët do të mbeteshin pa përkrahje dhe do të ktheheshin në fenë e krishtenë, sepse, sipas saj, muslimanizmi ishte fe aziatike dhe nuk kishte rranjë në Evropë. Kështu, gjithnjë sipas saj, baza fetare, tek e cila mbështetej Turqia në Shqipni, do të mos ishte ma dhe Shqipnia do të kthehej sërish në gjendjen e herëshme, para-osmane. Tue kalue në çështje konkrete të lëvizjes kombëtare, ajo propozon themelimin e disa institucioneve kulturore në Shqipni dhe jashtë saj, gjithnjë për dobi të luftës politike të çlirimit.

«Këto institucione — i shkruen ajo poetit me 14 nandor 1866 — tue mos mujtë me qenë ende politike, duhet të marrin një trajtë letrare dhe në dukje jo sulmuese për turqtë. I pari nga këto institucione do të ishte një Shoqatë letrare, që do të merrej me kërkime të të gjitha përmendorevet të gjinisë së Shqipnisë, kangë populllore, dorëshkrime kartulare, etj. Asht e vërtetë se, pa folë për letërsinë e popullit, minë e pashterrëshme e traditave kombëtare, përmendoret e letërsisë, dikur të lulëzueme, janë pasë zhdukë nga turqtë, në epokën e konspiracionit të madh të organizuem nga meshëtarët e gegënisë dhe nga përndjekja e tmershme që detyroi

dijetarin argjipeshkv të Prizrendit, Bogdanin, me u strehuv në Raguzë. . . Krijimi i një shoqate letrare mund të përligjet, pra, me arësye të shkëlqyeshme».

Lidhë me çështjen e themelimit të këtyne institucioneve, ajo vazhdon:

«...do të duhej me krijue në Kalabri një Akademi Shqiptare, qëllimi zyrtar i së cilës do të ishte, në shembullin e Akademisë Frengë të Risheljesë, me u marrë me fjalorin kombëtar, por që do të përpiquej me u bamë shpirti i popullit shqiptar, tue punue për t'i frymëzue, pa reshtje, frymën e unitetit, e cila do të shëronte të ligat shekullore».

Ajo tregon pastaj sesi do të organizohej kjo Akademi, se si në të do të merrnin pjesë si anëtarë vetëm njerëzit me prejardhje shqiptare, kurse albanologët e huej do të ishin vetëm anëtarë korespondentë dhe anëtarë nderi. Sipas saj, *Shoqata Letrare* do të ishte një vegël e Akademisë. Ndërkohë, ajo largohet nga Livorno dhe shkon në Veneti, për të kalue stinën e dimnit dhe për të vazhduë kërkimet nëpër arkiva. Ngulet në Palaco Foskolo, gran kanale, nga i shkruen poetit arbënesh, më 9 dhjetor 1866:

«Po ju shkruej nga Venetia, ku kam qëllim me kalue dimnin. Meqenëse e përnderuemja Republikë ka pasë marrëdhanie të gjata dhe intime me Shqipninë, unë kam ndër mend me bamë kërkime në arkivat veneciane. Veç kësaj, këtu Shqipnia duket gjithëkah, nëpër përmen-doret, nëpër kujtimet, nëpër institucionet; gjin-

det, bile edhe një Bashkëvëllazni Shqiptare.

Fletoret merren shumë me atdheun e etënve tanë, ku, thoshte dje Tempo, zien e vëlon diçka nga e cila gja turqte kanë frikë se mund të përtohet një kryengritje e përgjithëshme.

Prap nga Venetia, më 29 dhjetor 1866, ajo i shkruan:

«Gjeneral Garibaldi asht shpejtue të më shkruejë e të më thotë se e pëlqen plotësisht projektin e Akademisë Shqiptare. Unë mendoj se ai do të më flasë ma gjatë rreth këtij subjekti. Në qoftë se kryengritja e përgjithëshme, që Gazeta e Augsburgut lajmëron për muejin e marsit, shpërthen në Shqipni, kam mjaft arësye të mendoj se ai nuk do ta linte pa e përkrahë me njerëz dhe inkurajime. I thoni Zotni Dorsës se na kemi 15 deri më 20.000 pushkë 15 frangëshe me cilësi të shkëlqyeshme dhe që unë mund të disponoj po sa që të bahem me dijtë».

Siç shihet, ajo ishte hedhë në veprimtari të gjallë në përgatitje të kryengritjes shqiptare me armë, kishte ndërmjetësue për të sigurue armë, kishte hy në lidhje me personalitete të ndryshme shqiptare dhe të hueja për këtë qëllim. Ma tutje, po në këtë letër, ajo e lajmëron mikun e vet poet:

«Zotni Felice Skiavoni, piktor historie i shquem i Venetisë, ka fillue, sipas këshillimit tim, një tablo që simbolizon sprovat dhe përtëritjen e Shqipnisë».

Ajo nuk asht zhytë në arkivat e Venetisë për t'u shkëputë nga ngjarjet e ditës, nga çështja e shtrenjtë

shqiptare, por për të kërkuar landë dokumentare, me qëllim që me i shërbye gjëndjes aktuale të Shqipnisë, tue mos reshtë së lidhuni gjallënisht me çka po ndodhte nëpër botë, veçanërisht në Shqipni.

Ndërkohë, fama e saj ka marrë dhenë. Dijetari gjerman Dr. Kurtz, tue e krahasue me Zonjën de Staël, ka thanë:

«Dora d'Istria asht, pa dyshim, ma e naltë për nga karakteri». ¹²⁾

Edhe Dr. Adam Volf, historian i njohun i Marie Terezës dhe i Marie Kristinës, pasi i bani vizitë Dorës, e vlerësoi këtë ma nalt se Zonjën de Staël. ¹³⁾

1. Breazu I.: *Dora d'Istria si Edgar Quinet*, Cluj, 1931.

2. *Operele Doamnei Dora d'Istria*, trad. G.G. Peretz, Bucuresci, 1876, f. 99.

3. Jorga N.: *Lettres de Dora d'Istria, në Revue historique du Sud — Est — Européen*, IX, 1932, ff. 134-209.

4. *Fondi De Rada*, dosja Nr. 333-536, 54/1

5. Dora e parë e këtij studimi doli në faqet e fletores *L'Esperance*. U përkthye rusisht copë-copë, në të përkohëshmen *Ruskoe Slovo*, në greqisht me titull *Gratë në Anatoli*, etj.

6. Sp. Fishta F.: *Dora d'Istria*, po aty, f. 246.

7. Sp. Fishta F.: *Dora d'Istria*, po aty f. 249.

8. Dora e parë, më 1865, në Paris dhe Bruksel, në 2 vëllime; u përkthye në të përkohëshmen ruse *Zagranicni Vjestnik*, në *Gazzetta Ufficiale del Regno d'Italia*, 18 shtator 1865, shtojcë e prof. Francesko dell' Ongaro. Mbi këtë vepër shkroi prof. C.F. Gabba: *La questione femminile e la principessa Dora d'Istria*, Firenze, Le Monnier, 1865.

9. *Fondi De Rada*, po aty, përkthimi shqip nga origjinali

frengjisht asht i imi. Për letrat e tjera të këtij Fondi do të shenohet vetëm data dhe ndonjëherë vendi i dërgimit.

10. Sp. përk. të Kastrati J.: *Letrat e Dora d'Istrias në Arësimi Popullor*, maj-qershor 1963, Nr. 3, f. 120.

11. Sp. përk. të Kastrati J.: *Letrat e Dora d'Istrias* po aty, f. 122.

12. Sp. Fishta F.: *Dora d'Istria*, po aty, f. 247.

13. Sp. Fishta F.: *Dora d'Istria*, po aty, f. 247: *Ein Besuch in Livorno* (Neue Freie Presse, 16 maj 1866).

Edhe Dr. Adam Volk është i njohur i Mërisë
Tërësisht dhe i Mërisë Kristine, pasi i kemi vizitë Do-
rës e vlerësuarë me mallë me Konjën dhe Shtetë.

1. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866
2. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866

3. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866
4. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866

5. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866
6. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866

7. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866
8. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866

9. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866
10. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866

11. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866
12. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866

13. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866
14. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866

15. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866
16. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866

17. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866
18. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866

19. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866
20. Letra e Dora d'Istrias të datuar më 1866, G. J. 1866

KAPITULLI I KATËRT

KËRKIME, STUDIME, KRIJIME...

«Ajo u ba kampioni i palodhëshëm i çeshtjes së kombësivet; ajo nxori në dritë problemet thelbësore dhe jetike që i përkasin së ardhmes politike dhe shoqnore të helenëve, shqiptarëve, rumunëve, sllavëve, zgjidhja e të cilavet do t'u lejonte këtyne popujvet të hynin në rrymën e madhe të jetës moderne...»

«Larousse»

Paris, 1870, vëll. VI. f. 1107.

«Unazë e qutetnimit midis Lindjes dhe Perëndimit».

Dh. Kamarda

Rreth vitit 1870, kapitalizmi në Evropë nis e priret për t'u shndërrue në kapitalizëm financiar. Lufta për tregje sa vjen dhe ashpësohet. Përkrah Anglisë dhe Francës, si fuqi të mëdha çfaqen edhe Gjermania e Austro-Hungaria. Kjo e fundit, që za-

vendësoi Austrinë më 1867, u detyrue të largohet nga gadishulli italik, si pasojë e thyemjes që pësoi më 1866; ajo u detyrue, gjithashtu, të tërhiqet nga «Konfederata Gjermane» ku mbizotnonte Prusia. U krye bashkimi i Gjermanisë, pasi që thye Napoleoni III, i cili u zhduk nga skena historike. Me thyemjen e Napoleonit, që me tallje Viktor Hygoi e quejti «Shqiponjë e vogël», Franca u bë, për të tretën herë, republikë. Rusia përfitoi nga lufta frango-prusiane për të heqë qafe kufizimet e traktatit të Parisit, i cili ja ngushtonte të drejtat në Detin e Zi. Turqia, në shpërshje të vazhdueshme, paraqitet e trandun nga përpëlitjet e mbrendëshme dhe nga stuhia e një lufte të re. Në Rumani, bujerët pronarë të mëdhej tokash dhe disa elemente të borgjezisë mbështillen në partinë konservatore, që udhëhiqet në fillim nga bejzadeja Dhimitër Gjika. Kushtetuta që u pranue atëherë, që një kopje e asaj belgjiane. Ndërkohë, klubet punëtoresh dhe fshatare zhvillojnë një punë të dendun me karakter kulturor dhe shkencor. Në fushën e letërsisë krijohen vepra të mëdha. Mihail Eminesku vazhdon të botojë poezitë e veta të famëshme, ndër-sa Ion Kreangë harton *Amintirile din copilarie* («Kujtimet e fëmënisë») dhe Ion Gjika *Scrisorile* («Letrat») drejtue poetit Vasile Aleksandriu, ku evokon jetën e shoqnisë rumune të gjysmës së parë të shekullit XIX. Aleksandriu boton drama, kurse Ion Slaviçi novela dhe tregime të frymëzueme nga jeta e zanatçijve dhe fshatarëve. Ion Luka Karaxhale me komeditë, fletorari Barbu Shtefënesku-Delavrança me skica dhe novela romantike, Duiliu Zamfiresku me romane, Gjorgje Koshbuku me poezi fshatare, Al. Vlahucë me poezi qytetare, novela dhe skica, plotësojnë tabllonë e letërsisë rumune të kësaj kohe, që përban periudhën e saj klasike. Në fushën e shkencës,

B. P. Hashdeu i shpie ina tej punimet gjuhësore dhe boton, nën kujdesin e Akademisë Rumune, koleksionin me dokumenta të hueja, që kishin lidhje me historinë e rumunëve, — *Colectia Hurmuzaki* («Koleksioni Hurmuzaki») — kurse A. D. Ksenopol veprën madhore *Istoria Românilor din Dacia Traiana* («Historia e Rumunëve të Dakisë Traiane»), që ishte një hap i ri në përparimin e historiografisë rumune. Në pikturë, çfaqet si talent i rrallë N. Grigoresku.

Me një hov të ri paraqitet lëvizja politike në Shqipëri dhe jashtë saj, nëpër kolonitë arbëreshe. Më 1869, vala e pakënaqësisë ndaj pushtetit qendërues turk merr në Shkodër një pamje revolte. Me mija malësorë rrokin pushkën, mësyjnë Shkodrën me qëllim që, në bashkëpunim me qytetarët shkodranë, me i ramë garnizonit turk. Por paria e qytetit iu shmang lëvizjes dhe i la në baltë forcat e revoltueme. Në Kosovë, njana pas tjetrës, plasën gjithashtu revolta: ajo e rrethit të Prizrendit, Gjakovës dhe Pejës më 1866, ajo e Krasniqes me 1867 dhe ajo e Pejës më 1869. Kështu, përpjekjet e turqvet për të zbatue me dhunë reformat e reja acaruen antagonizmin midis popullit shqiptar dhe sundimtarëve turq. Krahas lëvizjes politike, mori hov edhe lëvizja kulturore. Në terrenin arbëresh të Italisë, De Rada vazhdon të qëndrojë në ballë të përpjekjeve për dobi të çështjes shqiptare. Më 1868, ai merr drejtimin e gjimnazit italisht të Koriliano-Kalabros, ku punon deri më 1878. Me teprica të mbetuna ai themeloi aty një shtypshkronjë të vogël, ku botoi dy librat e parë të poemës *Skanderbeku i Pafaan* (1873) dhe rishtypi ndonjë vepër të maparëshme. Santori, i larguem nga kuvendi dhe i tërhequn në fshatin e lindjes, jeton në kushte të randa ekonomike, tue e fitue jetesën me mësimë që jep në shkollën e fshatit dhe tue shitë

objekte dhe vegla druni që i punonte vetë. Gavril Dara i Riu, garibaldin i orëve të para, më 1867 punon si prefekt i qytetit Trapani të Sicilisë perëndimore, detyrë nga e cila, për shkaqe politike që nuk dihen, largohet më 1869, shkon në Romë, ku, nga 1871 deri më 1874, bashkëpunon në fletoren me prirje të majtë *La Riforma*. Zef Serembeja krijon disa nga lirikat ma të bukura atdhetare dhe dashunore. Në njanën sosh, botue më 1870, ai kërkon lirinë e Shqipnisë dhe shpreh besimin se dita e bardhë e çlirimit asht e afërme. Po atë vit, ai ngre nalt zanin kundër shovinizmit grek, kurse udhëheqësit të kryengritjes së përgjakëshme në Kretë kundër zgjedhës turke, Koroneut, më 1867, i kushton një nga lirikat ma prekëse. Vinçenc Stratigoi, pasi u kish pri pesëqind këmishëkuqvet ungriotë dhe kish arritë të bahej kryeshtatmadhor, tërhiqet tashti në fshat, besnik i ideve revolucionare garibaldine, i pakënaqun se fitoret e kryengritjes i korri parësia dhe jo vegjëlia. Më 1874, policia i bastisi shtëpinë, tue ja zhdukë dorëshkrimet dhe tue i sjellë kështu një dam jo të vogël letërsisë arbëreshe.

Edhe në terrenin arbënesh të Greqisë zu të mullulojë shkrimi shqip. Më 1870, nga ishulli Hidra, arbëreshi Gjergj Driva i kushton një poezi evarie Dorës. Po këtë vit, Panajot Kupitori, gjithashtu hidriot, botoi një studim gjuhësor rrethi së folmes arbëreshe të Hidrës.

Në Shqipni, letërsia zhvillohet dhe pasunohet me vepra të reja. Që në fillim të vitit 1867 Zef Jubani krijonte lidhje me De Radën dhe Dorën për çështjen shqiptare. Më 1871, ai boton në Trieshtë librin *Raccolta di canti popolari e rapsodie di poemi albanesi* («Përmbledhje kangësh popullore dhe rapsodi poemash shqiptare»). Leonardo De Martino, i lidhun në letër-

këmbim me Dorën, boton, më 1868, në fletë më veh-te, një përshtatje të poezisë së T. Grosit, *Vaji i hap-ses*, të cilën e quen «simbol i lehtë i vajtimit të Shqip-nisë». 1) Në fillim të vitit 1870, Eftim Mitkua hjedh kushtrimin për të rrëmbye armët kundër sunduesit turk. Edhe ky asht i lidhun në letërkëmbim me Do-rën. Vjersha atdhetare në frymë popullore dhe kun-dër shkelësit otoman shkruen që më 1868 edhe Spiro Dineja.

Kostandin Kristoforidhi, i lidhun me Shoqinë Biblike Angleze, përktheu dhe botoi *Katër katekizmat* (1867) dhe *Dhiatën e re* (1872). Për shkollat e para shqipe, ai hartoi dhe nxori në dritë, më 1872, një Abetare. Pashko Vasa, më 1873, doli me vëllimin lirik italisht *Rose e spine*. («Trandafila dhe gjemba»). Ndërkohë, në Stamboll, ky, Kristoforidhi, Jani Vre-tua, S. Frashëri, Hoxhë Tahsini dhe Ismail Qemali, tue fillue nga 1872-ja, lidhen në veprimtari atdhe-tare.

Për shumë nga këto ngjarje kulturore dhe le-trare ishte në dijeni mendimtarja jonë. Në këtë rry-më të përgjithëshme lëvizjeje kombtare dhe përtë-ritjeje kulturore, ajo merr pjesë gjallënisht. Me shu-më nga fytyrat e shqueme shqiptare të kohës ajo ka lidhje të drejtpërdrejta nëpërmjet letravet. Janë vitet e vlugut të punës, vitet e kërkimeve, studimeve dhe krijimeve të saja të njohuna, që kunorëzohen me veprën madhore *Gli Albanesi in Rumenia* («Shqip-tarët në Rumani»), botue më 1873.

Në *Revue des deux mondes*, më 1 gusht 1867, ajo bani të ditun artikullin *La nationalité hellénique d'après les chants populaires* («Kombësia helenike si-pas këngëve popullore»); po atë vit, ajo dha vepërzën përshkruese të udhëtimit *Le golfe de la Spetzia* («Gjiu i Species»), ku ndalet te arbneshët e Greqisë, sidhe

Les écrivains albanais de l'Italie meridionale («Shkrimtarët arbëreshë të Italisë jugore»), së pari në të përkohëshmen *Indépendance hellénique* të Athinës, sjell gjermanisht në *Internationale Revue* të Vjenës dhe italisht më vehte nga Nikollë Kamarda. 2) Në këtë të fundit, ajo përkroi letërsinë arbëneshe të Italisë përmes disa autorëve të saj në shenjë. Me të drejtë u tha se kjo vepër, sikurse edhe të tjerat para saj, «ishte një nxitje e fortë për tonët të vazhdojshin rrugën që kishin fillue ndër kohë të reja» si De Rada me shokë.

Ndërkaq, ajo vazhdon në mënyrë të dendur letërkëmbimin me De Radën. Nga Venetia, më 9 janar 1867, ajo e njohton poetin:


«*Studimi im rreth shkrimtarëve arbëreshë të Italisë jugore do të dalë në dritë njëkohësisht në Veneti, në Athinë dhe në Vjenë, në italishte, frengjishte dhe gjermanishte.*»

Po aty, ajo e veni në dijeni mikun e vet:

«*Gjeneral Garibaldi ka dërgue në Lindje (Ballkan, V. B.) njanin nga burrat e vet ma të fortët, arbëresh nga Hora e t'Arbëreshëve. I kam dhanë disa letra.*»

Ma tej, ajo i tregon atdhetarit të shquem arbëresh se si kishte nisë letërkëmbimin me Zef Jubanin në Shkodër dhe mbi gjendjen e vështirë shëndetsore të dijetarit italian N. Tomazeo, i cili çfaqte interesim për shqipen dhe shqiptarët. Me të madhe ngrihet ajo në mprojtje të kryengritjes kretase dhe në luftë kundër panhelenizmit:

«*Po ju dërgoj — i thotë nga Venetia De Ra-*



Zef Jubani

dës më 7 shkurt 1867—artikullin tim mbi kryengritjen kretase, artikull që provon se jam e para në mbështetjen e pretendimeve të ligjëshme të grekëve. Por sa ma tepër që jam përkrahëse e pretendimeve të ligjëshme, aq ma pak jam e vendosun me pranue ekstravagancat e panhelenizmit. Gjithashtu fort jam çuditë kur kam pamë se qysh një njeri si Z. Krispi, që duhet ta njohë historinë e vendit të vet, u jepte zemër (shih letrën e bashkëngjitur, botue nga fletoret e Athinës, në të cilën ai e shpall vehten «grek nga preardhja». Kjo letër jep një ide të veprimtarisë dhe të shtrimjes së disa intrigave, dhe provon, siç ju thosha ma parë, që nuk duhet të vonohemi me organizue forcat intelektuale dhe morale të shqiptarëve. Ndryshe, njeriu do të mbetej në shenjë për t'u vumë në lojë».

Denoncimin e intrigave të panhelenizmit dhe ekspansionizmit italian ndaj Shqipënisë ajo vazhdon ta bajë në letrën e 10 shkurtit 1867, po nga Venetia:

«Fatkeqësisht egziston një intrigë greke, tek e cila hjedh fjalën një korespondencë nga Shqipëria, botue në Tempo të Venetisë, që ka për qëllim një ndamje të Shqipënisë midis grekëve dhe italianëve. Këta të fundit, me t'u bamë zotë të Dalmacisë, do të shtinin në dorë Gegëninë. Ju i shihni po aqë qartë si unë kundërshtitë dhe rreziqet e këtij plani, kaq pak përshtatë parimit të kombësisë, përmendë nga Greqia dhe Italia».

Tue vazhdue ta mbajë në rend të ditës çështjen e Akademisë Shqiptare, ajo e lajmëron De Radën,

në letrën e 17 shkurtit 1867, se Dhimitër Kamarda po e përkrahte mendimin e saj për krijimin e Akademisë. Një muej ma vonë, më 14 mars, po nga Venetia, dijetarja jonë militante i rrëfen prap poetit për Garibaldin, lidhë me burrin arbënesh që ky kish dërgue në Ballkan:

«Gjeneral Garibaldi kishte dërgue në Greqi një njeri të besueshëm, njanin nga oficerët e vet ma të mirë, lindë në Hora të t'Arbneshëve nga një familje arbëneshë. Ky oficer asht kthye fort pak i kënaqun nga grekët dhe i bindun, përkundrazi, se Shqipnia zotnon të gjitha elementet e një kryengritjeje së plotë».

Ajo ishte bamë tashma një ndërmjetëse e vërtetë midis shkrimtarëve atdhetarë arbëneshë dhe të huejvet, që çfaqnin interesim ose vepronin në dobi të Shqipnisë. Më 12 maj 1867, gjithnjë nga Venetia, i shkruen De Radës:

«Po shti në postë për ju dy egzemplarë të shkrimit të ri të Papas Kamardës. Çështja filologjike po merr çdo ditë randësi, sepse pansllavizmi aspak nuk ka heqë dorë nga mbështetja e prejardhjes sllave të shqiptarëve».

Dhe ma poshtë:

«Njana nga mikeshat e mia, poetesha e Vjenës, baronesha Knorr, m'asht lutë që të ju lyp për 'te një egzemplar të Poema Nazionale. Pasi që autorja e Irene-s ka marrëdhanye të vazhdueshme me letrarët austriakë, kam mendue se unë do të mund të baja me besue që ju do të dëshironit me ja plotësue dëshirin».

Po për këtë poeteshë vjeneze, që do të përkthejë ma vonë vargje të De Radës në gjermanishte dhe do të bashkëpunojë nëpër organe letrare arbneshe, Dora i shkruen poetit të Makjit edhe ndër letrat e 16 qershorit dhe 19 korrikut 1867, 18 shtatorit 1872 dhe 21 janarit 1873. Në vazhdim të letrës që kemi në dorë, ajo e njohton poetin:

«*Dhoma greke më ka dhanë njëzani natyralizimin e madh për arësye se kam mbështetë të drejtat e Greqisë kundër Turqisë, veçanërisht në veprën time Excursions en Roumélie et en Moré*»

Mendarja jonë e shkathët kthehet sërish te çështja e pagzjidhun e institucioneve kulturore:

«*Puna e Akademisë — i shkruen nga Venetia autorit të Milosaatit më 29 qershor 1867 — nuk asht e vetmja që duhet të interesojë sot për sot kolonitë arbneshe. Do të ishte diçka shumë me randësi sikur kolegji i Shën-Adrianit të kthehej në një shkollë universitare, e gjallë dhe vepruese, me qëllim që të bahej për arbneshtë e gadishullit e tillë siç asht këtu Shën-Lazri për Armenët e Lindjes dhe të Perëndimit, don me thanë një vatër arësimi të epër. Asht një mendim që nuk po baj tjetër veç sa po e çek, por mbi të cilin do të kem me siguri ma se një rasë me u kthye përsëri. Themelimi i Shën-Lazrit ka qenë sinjali i përtëritjes së jetës intelektuale te Armenët. Pra, pa rilindje letrare s'ka aspak përtëritje politike!*»

Ajo ndiqte me vemendje qëllimet e pansllavizmit,

në Rapalo, krahinë e Gjenovës, nga fundi i motit 1870, dhe në Firenze, që më 1871, përfundimisht.

«Shqiptarët kanë bamë, në mënyrë të dukëshme, një gabim të madh — i shkruen De Radës më 18 gusht nga Pelji - që nuk kanë përfitue, siç kanë përfitue serbët dhe rumunët, nga lufta ndaj kretasve dhe orvatjet e pamatuna të Sulltanit për të shti në dorë koncesione të mëdha. Porta (Porta e Lartë, V. B.) copëton tashti shpatën, që i ka shërbye kundër Kretës. Sistemi qendrëzues, kaq i volitshëm për despotizmin, sistem me të cilin ajo asht mveshë, nuk lejon me respektue autonomitë lokale. Mbetet për të pamë, Zotni, se qysh shqiptarët do të durojnë mosmirënjohjen e turqvet. Ka mundësi që, po sa të paraqitet një rasë, ata do t'i bajnë me e pague shumë shtrenjtë!

Në përgjithësi, të rejat nga Lindja (Ballkani, V. B.) nuk paraqesin ndonjë gja krejt të kënaqëshme. Pansllavizmi, prirjet e të cilit i treguen tash vonë ngjarjet e Shebenikut, po e mbush Lindjen (Ballkanin, V. B.) me intrigat e veta. Ai pak paqëtim, që mbretnon midis kombevet pellasgjike, nuk u lejon fare atyne me i bamë ballë kësaj propagande vepruese».

Paç dy muejsh, ajo i sjell dy shenime De Radës. Në letrën e dërgueme nga Torinua, Piaca delo Statuto, më 21 tetor, lexojmë:

«Asht për të ardhë keq që autori i Albania-s (Pietro Chiara, V. B.) s'ka folë për Shqiptarët e Rumanisë — Vasil Shqiptarin, Dukajt dhe mbi të gjithë Gjikaajt.

dhe:

«Kam për të ju bamë të ditun një lajm të hidhun: Dr. Hahn ka vdekë. Asht një humbje e pandreqëshme për letërsinë shqipe».

Më 1870, ajo hidhet në çështje gjithnjë të lar-me, që i interesojnë gjuhës, letërsisë, historisë shqiptare:

«Venetët primitivë — i shkruen De Radës nga Torinua më 7 prill 1870 — nuk ishin as Scitë, as sllavë, por Ilirë e Proto-Shqiptarë, sikurse fiset e tjera të të dy brigjeve të Adriatikut».

Dhe, për të forcue argumentin, ajo përmend studimtarin italian Bartolomeo Çeketin, që e pranon diçka të tillë në veprën e vet *La vita dei Veneziani fino al 1200* («Jeta e Venedikasve deri më 1200»). Me të madhe shtron ajo nevojën e lidhjeve ma të ngushta midis kolonivet shqiptare.

«Z. Perrot, redaktor i *Revue des deux Mondes*, që ka vizitue «kufitë ushtarake» (Hungari), ka gjetë aty një koloni shqiptare, e cila, thotë ai, ka ruejtë me kujdes gjuhën dhe doket e të parëve tanë. Sa asht për të ardhë keq që nuk egzistojnë marrëdhanie midis kolonive të ndryshme! Mungesa e marrëdhanieve të tilla asht shkaku kryesor që e ban kaq të vështirë restaurimin e gjuhës dhe të historisë kombtare».

i shkruen nga Torinua, me 20 janar 1870, mikut të vet të pandamë arbënesh. Tue vazhdue me i sjellë të reja të tjera të veprimtarisë së vet dhe të së

tjerëve shqiptarë, ajo i shkruen nga Rapalua, më 3 shtator 1870:

«*Kam nxjerrë në dritë në Revue des deux Mondes (1 gusht) punimin tim La poésie populaire des magyars («Poezia popullore e maxharëve»)*

dhe:


«*Nuk di në ju kam thanë se përkthyesi i Psallmeve Z. Kristoforidhi i Elbasanit, ka krye përkthimin e Dhjatës së Re».*

Me artikullin *Poezia popullore e maxharëve* ajo zgjanoi planin e nxjerrjes në pah të poezisë popullore të popujve të Evropës jugë lindore, me qëllim që me pohue genien e këmbësive përkatëse, kurse me informimin rreth shqipërimeve të Kristoforidhit ajo dëshmonte se ishte në dijeni të pamjeve dhe çaseve kryesore të lëvizjes sonë kulturore në atë kohë.

Më 1871, Dora d'Istria jepet ende ma shumë pas kërkimeve të dokumentave rreth historisë së shqiptarëve. E ngulun tashma përfundimisht në Firence, në Vila d'Istria, siç quhet vila e saj, ajo nuk reshtë së vajtuni, andej e këndeje, jo vetëm për pushime verore a dimnore, por edhe për hulumtime nëpër arkiva të ndryshme.

Një punë të madhe bani dijetaria jonë për popullarizimin e çështjes shqiptare para opinionit publik botënor. Më 15 shkurt 1871, ajo e lajmëron shokun e idealit atdhetar, De Radën:

«*Më kanë kërkue në Amerikë fotografitë, jetëshkrimet dhe autografet e poetëve dhe dijetarëve evropianë. Fotografinë tuej e kam nisë*



Thimi Mitko

që prej kohëshi, prandaj ju lutem të më dërgoni një autograf dhe një fotografi tjetër për mua».

Dhe më 10 prill 1871, nga Firenze, i dërgon këto radhë:

«Ka ardhë koha që historia jonë të dalë gjithashtu nga varri, ku e kanë gropue kaq e kaq farisej».

Më 22 maj 1871, po nga Firenze, vazhdon t'i rrëfejë për këtë punë:

«Pa dyshim, Zotni, unë provoj një kënaqësi të veçantë për të rindërtue këtë histori të Shqiptarëve, fletët e së cilës duken të përndame nëpër botë, në Evropë, në Azi, në Afrikë, «lojë e ernave të shpejta, si flatrat e Sibilës së Virgjilit».

Me letrën e 19 korrikut 1871, ajo i dërgon poetit të shquem arbnesht një listë të gjatë emnash të dijetarëve, që interesoheshin për çështje të gjuhës shqipe: Maks Myler, Shtier, Breal, Opert, Brokhaus, etj. Ndërkaq, si ndërlidhëse e shkathët e kolonive shqiptare, ajo vazhdon me mbajtë gjallë lidhjet midis përpjekjeve të ndryshme që sjellin dobi në lëvizjen kombtare:

«Kam dërgue egzemplarët e gramatikës (së Zef De Radës, V. B.) në Rumani dhe në Shqipni».

e njohton De Radën nga Rapalo, më 30 gusht 1871. Gjatë këtij viti dhe, sidomos, gjatë vitit pasues, ajo

merret dendësisht me studimin e qëndrimit të Shqiptarëve në Rumani. Më 6 maj 1872, nga Firenze, ajo i rrëfen poetit:

«Jam gjithnjë fort e zanë me shqiptarët në Rumani».

Dhe, po për këtë punë, më 18 shtator 1872, nga Porto Mauricio, Vila Litardi, vazhdon të rrëfejë:

«Telegramet frenge nuk harrojnë me thanë se, ndonëse natyralizue në Rumani që herjet, familja e Grigorit IV (Gjika, V. B.) asht me prejardhje shqiptare».

Pa u largue nga ngjarjet e ditës, sidomos nga ato që i jepnin dorë ose që pengonin çështjen shqiptare, Dora d'Istria i shkruen poetit, po në këtë letër, për rrezikun që sjell shovenizmi i huej ndaj Shqiptarisë:

«Pangjermanizmi ka zgjue, siç ishte lehtë për t'u parapamë, të gjitha zjarmitë e pansllavizmit dhe retë grumbullohen gjithnjë ma tepër në anën e Lindjes (Ballkanit, V. B.). U duhet dhanë pra njerëzve të Lindjes këshillimi që Kromvelli u jipte «krahëve» të vet «të hekurtë»: «Lutiuni Zotit dhe mbanie barutin tuej të thatë!»

Njeriu çuditet me njohunitë e saja të shumta rreth çdo lajmi, veprë, ngjarjeje a lëvizjeje në dobi të çështjes shqiptare. Me këtë veprimtari që zhvillonte, me autoritetin dhe reputacionin që kishte në botën e qytetnueme, ajo u bë një frymëzuese e madhe për arbneshtë e Italisë, për shqiptarët e kolonive të tjera dhe të vendit. Ma se një herë ajo doli mike dhe

mprojtëse e shkrimtarëve dhe atdhetarëve shqiptarë të kohës, e De Radës, Dh. Kamardës, Z. Serembes, L. De Martinos, Z. Jubanit, P. Zarishit, etj. Ja, p.sh. se qysh e bam të njohun fytyrën e L. De Martinos dhe të P. Zarishit, në *Rivista Europea*, më 1 gusht 1872:

«Ndonëse frati Leonardo De Martino di Greçi M. O. asht lindë në Itali, në koloninë arbneshe të Greçit (Kapitanatës), ai asht identifikue tash sa vjet me Gegëninë, ku ushtron detyrat e misionarit apostolik. Ai ka mendue se poezia mund të jetë një këshilltare e mirë për popujt, që gjinden në mjerim dhe, kur ajo shpreh ndjenja të larta, një mjet shumë i fuqishëm përtëritjeje... Poezitë e tija, të shtypuna me shkronja latine në fletë fluturuese, janë caktue të përhapen nëpër popull... Prifti aktiv i Troshanit androni tashti të botojë pjesën ma të randësishme të veprës poetike të dom Zarishit... Dom Zarishi, që ishte një bashkëkohës i yni, ka lanë poezi të bukura shqipe, të cilat, për shkak të një gjendjeje shoqënore shumë pak të volitëshme për jetën letrare, nuk vonuen me u zhdukë, ashtu sikurse janë zhdukë gjithë ato shkrime të tjera, që kanë humbë në valën e kryengritjeve dhe luftave të pambarim, teatër i të cilavet asht Shqipnia qysh nga fitorja muslimane... Na duhet pra ta përgëzojmë fratin Leonardo De Martino di Greçi, që ka pasë mendimin e bukur me ja bamë të njohuna publikut lexues, i cili ka në dorë një numër kaq të vogël tekstesh të një gjuhe, që, pa pasë randësinë e jashtëzakonshme të greqishtes dhe latinishtes, të pajisuna me kaq kryevepra, asht megjithatë një idiomë pellasgjike, e folun nga një komb i lashtë i racës së cilës Homeri i

jep epitetin «e hyjnueshme» racë që lot një rol të tillë qysh nga agimi i epokës historike, aq sa traditat e qëmoçme mistike e bijnë se asht lindë «përpara diellit dhe hanës». ⁴⁾

Më 1 shkurt 1873, në *Revue des deux Mondes*, Dora d'Istria botoi artikullin *La poésie populaire des Turcs orientaux* («Poezia popullore e Turqvet lindorë»), i cili mbylli ciklin e artikujvet të kësaj natyre në të përkohëshmen e famëshme pariziane, tek e cila, brenda 14 vjetvët, që nga 1859 deri më 1873, nxori në dritë 7 artikujt e përmendun ma sipër. Në këtë kohë, ajo iu vu studimit të epopesë persiane, tue e shtrimë rrezën e studimit edhe në poezinë e popujve të tjerë, jashtë sferës së Evropës jugë lindore.

Më 1873, gjithashtu, ajo përfundoi dhe botoi në Firence veprën madhore *Gli Albanesi in Rumenia* («Shqiptarët në Rumani»), histori e princëve Gjika në shekujt XVII, XVIII dhe XIX, mbështetë ndër dokumenta të pabotuem të arkivave të Venetisë, Vienës, Parisit, Berlinit, Konstantinopolit, etj. Ma parë, këtë vepër, në *Rivista Europea*, Bartolomeo Çeketi, përkthyesi në italishte dhe jetëshkruesi i saj, e shoqënoi me jetëshkrimin dhe bibliografinë e veprave të saja të periudhës 1855-1873. Qëllimi i autorës ishte me vu në dukje mërgimin dhe nguljen e Shqiptarëve në Rumani, veçanërisht me nxjerrë në pah prejardhjen dhe rrjedhën historike të familjes së vet Gjika. Kjo vepër i kushtoi shumë mund dhe kujdes. Në letrat dërgue De Radës më 22 janar 1872, më 6 maj 1872, etj. ajo përmendte punën e vet me ngulm mbi këtë vepër dhe faktin që arkivat e Vjenës kishin dokumenta të randësishëm rreth kësaj teme. Shihet qartë se ajo nuk ka punue si një publiciste e thjeshtë, por me dokumenta në dorë, me ar-

gumenta bindës. Atë e udhëhiqte pasioni i dijetares për të hjedhë dritë dhe për të nxjerrë përfundime në historinë e shqiptarëve të shpërngulun, në fuqinë krijuese të gjenisë së tyne.

Dora d'Istria ka arritë tashma kulmin e krijimtarisë dhe të zulmës. Në parathanjen e kësaj vepre në italishte Çeketi shënonte me të drejtë:

«Ajo vjen tue na shtjellue aso studimesh, të cilat na detyrojnë t'i lexojmë me kujdesin ma të madh, për të mujtë me nxjerrë fryt nga ato. Studimet e saja përmbajnë në vetvehte një lëndë erudicioni të dendun dhe, njëkohësisht, janë dëshmia ma e bukura e njohunivet të përgjithëshme që ka ajo për histori ndër veçoritë e saja ma të vogla. Dallohet për një natyrë përmbledhëse në studime të ndryshme, për dituni politike, për njohjen e dokeve dhe të shenjës dalluese të çdo kombi, fitue, ma tepër, se ndër udhëtime, që bajnë sa e sa njerëz, — në afrimin me popullin. Mendimtarët si Dora d'Istria nuk e lanë pas dore ta studjojnë popullin dhe ndër episode të vogla, ndër zakone dhe ndër prirje, ndër kangë të ndryshme, të kërkojnë çdo gja dhe gjithçka. ka të bajë me jetën e popullit dhe të përmbledhin, me ndërgjegjen ma të madhe, gjykimet e shkrimtarëvet, përmbajtjen e dokumentavet, burimet.»

Në periudhën nga 1868 deri më 1873, ajo bashkëpunoi jo vetëm në *Revue des deux Mondes* të Parisit dhe *Diretto* të Torinos, por edhe në *Spectateur d'Orient* dhe *Esperance* të Athinës, si dhe në shumë organe të tjera shtypi italiane, gjermane, etj. Në këtë periudhë, gjithashtu, u çmue me vlerësim të

posaçëm nga shumë institucione diturake, artistike, dhe kulturore të botës; tue u zgjedhë: shoqe nderi e «*Minerva-s*» së Trieshtes, shoqe nderi e «*Syllogo-s*» së Athinës dhe Stambollit, kryetare nderi e «*Helikon-it*» të Izmirit, shoqe bamirëse e Akademisë «*Raffaello da Urbino*»; shoqe letrare e «*Società per l'incremento del teatro in Italia*» («*Shoqata për rritjen e teatrit në Itali*»), nënkryetare nderi e shoqatës së grave greke për arësimin femnor, shoqe nderi e Akademisë «*Dei Quiriti*» të Romës dhe shoqe nderi e «*Parnasso-s*» së Athinës, anëtare e Akademisë «*Pittagorica*» të Napolit, korespondente e huej e Akademisë Ndërkombëtare të letrave dhe të arteve të bukura të Barcelonës, korespondente e huej e Institutit Arkeologjik të Buenos-Ayres, kryetare nderi dhe pajtore e «*Char*»-kut të Stambollit.

1. De Martino L.: *L'Arpa d'un italo-albanese* Venezia, 1881, f. 351.

2. D'Istria Dora: *Gli scrittori Albanesi dell' Italia Meridionale*; trad. N. Camar da, Palermo, 1867.

3. Vjollca e Skanderbeut: *Mirënjohtësi shqiptare në Shkëndija*, 1/1941, Nr. 11-12, f. 12.

4. *Rivista Europea*, Anno III, v. III, fash. III, 1-VIII, 1872, f. 624, riprodhue sp. Leonardo De Martino: *L'Arpa d'un italo-albanese*, po aty, ff. 376-382.

Përkthimi nga frengjishtja asht imi.

KAPITULLI I PESTË

NË VILA D'ISTRIA... VITET E FUNDIT

*«Prej gurre fort të kulluet shqiptare,
e shtrenjtë për shqiptarët, krejt kush-
tue çështjes së tyne, ajo asht e denjë
për nderimin që po i baj unë këtu.»*

Jozefina Knorr

Të sprasmet fuqi të mëdha, që zunë vend në sofrën e ndamjes së teritoreve për koloni, genë Italia dhe Gjermania. Sytë e shterrun për gllabërime të reja u sollën drejtë Evropës jugë lindore. Mbrenda vitevet 1875-1878, gjendja në Ballkan paraqitet mjaft e koklavitur: krijohet e përftohet ajo krizë, që u quejt e u njoht si «Krizë ballkanike». Në janar 1876, Mali i Zi dhe Serbia, lidhin besën dhe, në qershor, i shpallën luftë Turqisë. Gjatë gjithë ndeshjes, dy fuqitë sllave jugore u përkrahën nga Rusia. Por shpejt Serbia u nxuer jashtë ballit të përlëshjes dhe, thikë për thikë me ushtrinë osmane, ngeli vetëm Mali i Zi. Atëhere, Rusia shtrengoi dhambët dhe armët kundër zotit të Dardaneleveve. Në tetor të atij moti, ajo lidh fjalët me Rumaninë dhe,

në prill 1877, nënshkruen një konventë, sipas së cilës ushtritë ruse do të kalonin nëpër tokën rumune, për t'u ramë, bashkë me moldo-vllahët, aradheve turke në shpinë dhe në ije. Dhe, kështu, nis lufta ruso-turke. Por diplomacia angleze nuk po rrinte e ngujueme në vend. Në çastin kur trupat ruse kaluen Danubin, Albiona vu në lëvizje anijet andej nga Malta dhe drejtoi sytë nga Deti i Zi, sepse nuk donte që Harusha e Bardhë të zinte njak Stambollin. Kur mori vesh Austria fillimin e bisedimeve për armëpushim midis dy mundësve, i premtoi Anglisë ndihmën e vet ushtarake tokësore. Kundër carit u krijue një front i fuqishëm, prandaj ky, si i ra në erë kësaj pune, u nxitue dhe e nënshkroi, më 3 mars 1878, në Shën-Stefan, traktatin që do t'i ndërronte faqen hartës politike të Evropës jugë lindore. Ndër sa e sa shestime, ishte edhe një që thoshte se Mali i Zi, do të shtinte në dorë, ashtu nën hie, copa të mëdha toke të Shqipnisë, Hercegovinës dhe brigjeve të Adriatikut. Të pakënaquna nga ky traktat, Anglia, Austro-Hungaria dhe Gjermania ranë në godi të thërrasin në Berlin Kongresin e shtatë fuqivet të mëdha, që patën nënshkrue marrëveshjen e Parisit. Kongresi i bëri ndryshime traktatit të Shën-Stefanit. Si ves që e kanë tregëtarët e lirisë së popujve dhe grabitësit e pacipë të vendeve të tjera, pjesëmarrësit e Kongresit vendosën ta copëtonin Shqipninë, a thue se kjo ishte një plaçkë tregu, që nxirret në ankand a shitet e blihet sipas andjes dhe lakmisë së huej. E, midis njani tjetrit, zotnitë e mëdhej ndanë hiset e presë: Austro-Hungaria mori «për t'i administrue» Bosnjën dhe Hercegovinën, Anglia Qipron, Rusia Besarabinë, Karsin dhe Batumin. Perandoria osmane u mbajt ende gjallë pa u prishë.

Përballë kësaj gjendje, lëvizja shqiptare hyni në

një fazë të re. Lufta e popullit tonë mori nga ditë e ma shumë karakter të ndërgjegjshëm çlirimi kombtar. Rreth programit realist të Rilindjes u bashkuen të gjitha forcat e gjalla atdhetare. Tue përfutue nga «kriza ballkanike», në Mirditë plasi një kryengritje, më 1876, dhe në Kozencë u krijue një komitet i përbamë nga atdhetarë arbëreshë si Jeronim De Rada me shokë. Por kryengritja mirditore, e braktisun nga kreu i saj Prengë Bibë Doda, u shtyp. Në pranverën e vitit 1877, mbledhja e krenëve të Shqipnisë në Janinë parashtroi kërkesa për bashkimin e të gjitha vilajeteve të banueme prej shqiptarësh në një vilajet të vetëm, me një administratë të përbame nga nëpunës shqiptarë, me shkolla ku të mësohej shqipja, me ushtarë vendës që ta kryenin shërbimin mbrenda Shqipnisë. Por qëndrimi i pabesë i fuqive të mëdha u dha zemër shovenistëve fqinj që të lakmonin toka shqiptare. Më 12 shkurt 1878, bandat greke zbarkuan me flamur grek nga Korfuzi në afërsitë e Sarandës, në fshatin Lëkurës, dhe të nesërmen pushtuen Sarandën. Por, dhjetë ditë ma vonë, vullnetarët shqiptarë i shpartalluen. Doli në rend të ditës, pra, çështja e shpëtimit të atdheut nga ana e vetë shqiptarëve. U shtrua detyra e krijimit të një organizate, që ta udhëhiqte luftën e popullit kundër armiqvet të atdheut. Një organizatë e tillë u krijue në Stamboll, në fillim të vitit 1878, e quejtun *Komiteti Qëndror për mprojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare me anëtarë aktivë*: A. Frashërin, S. Frashërin, Pashko Vasën, J. Vreton, Zia Prishtinën. Në proklamatën e drejtueme popullit, më 30 maj 1878, Komiteti shprehte mbë nj'anë, zemratën kundër sulmeve shoveniste malazeze, serbe dhe greke, mb'anë tjetër, dëshirin e flaktë për të jetue në paqe me fqinjët malazez, serbë, grekë dhe bullgarë.

Lajmi se, së shpejti do të mblidhej Kongresi i Berlinit, vuni në lëvizje të gjitha forcat atdhetare mbrendë dhe jashtë vendit. Në qershor 1878, në Prizrend u krijue *Lidhja e Prizrendit* dhe u shpall besa e përgjithëshme për të pushue hakmarrjen me gjak. Lidhja lëshoi thirrjen për të mprojtë me armë atdheun kundër copëtimit. Krijimi i Lidhjes ushtroi ndikim të fortë në popull. Në memorandumin që qarqet përparimtare të Shkodrës, nënshkrue nga 500 vetë, i drejtuen, më 18 qershor 1878, kryetarit të dërgatës angleze në Kongresin e Berlinit, Lordit Bikonsfilld, thuhej:

«Shqipënia nuk mund të përfaqësohet nga qeveria otomane. Shqiptari, qoftë katolik, ortodoks a musliman, e urren pushtuesin turk po aq sa urren edhe çdo tjetër pushtues të huej... Ashtu sikurse nuk jemi dhe as që duem të jemi turq, po ashtu do të luftojmë me të gjitha forcat tona kundër cilit do që kërkon të na bajë sllavë, austriakë a grekë. Na s'duem të jemi tjetër veçse shqiptarë». 1)

Një memorandum i ngjashëm iu dërgue nga atdhetarët shqiptarë të Stambollit, më 2 qershor 1878, Kontit Andrash, kryetarit të dërgatës austro-hungareze në Kongresin e Berlinit. Edhe J. De Rada protestoi energjikisht kundër copëtimit të Shqipënisë, atje, nga Makji, ku kjo rrethanë e gjeti pa punë, ndërsa zunë t'i bijnë fatkeqësi të mëdha familjare. Mbrenda pak kohe u krijuen në atdhe shumë degë të Lidhjes dhe Komitete vetëmprojtjeje. Një veprim i fuqishëm luftarak, shenjë e luftës në dy krahët, kundër shovenistëve fqinjë dhe kundër shkelësve turq qe vrasja e mareshalit turk Mehmet Ali Pashës, në

Gjakovë, më 6 shtator 1878. Komiteti i Stambollit përpunoi një program të ri dhe këtë e botoi në 27 shtator 1878 në fletoren që nxirrte turqisht S. Frashëri në Stamboll, *Terxhumen i Shark* («Interpreti i Lindjes»). Aty shpallej kërkesa që të mos i lëshohet asnjë pëllambë tokë shqiptare asnjë fuqie së huej, të bashkoheshin të tria vilajetet në një të vetëm vilajet shqiptar, pa asnjë dallim fetar, me nëpunës që të dinin shqip, me shkolla shqipe, me milici shqiptare. Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes në Prizrend, në nandor të atij viti, përpunoi ato kërkesa që shpalli Komiteti i Stambollit. Ishte një hap i madh drejt autonomisë. Një veprim i shquem atdhetar që lufta për të mos ja dorëzue Malit të Zi Plavën dhe Gucinë. Në fillim të janarit 1880, ushtria malazeze sulmoi, por u thye nga ana e vullnetarëve të Lidhjes. Një tjetër veprim i shquem atdhetar që edhe lufta për mbrojtjen e Hotit dhe Grudës. Për këtë qëllim, në Shkodër, më 3 prill 1880, u sajue një *Lidhje mbrojtëse*. Te Ura e Rrzhanicës, më 22 prill, ushtria malazeze u thye prap nga ana e vullnetarëve shqiptarë. Një luftë mprojtëse u bë edhe në jugë kundër pretendimeve greke.

Në korrik 1880, në Gjirokastrë u mblodhën përfaqësues nga jugu dhe veriu, për të trajtue çështjen e autonomisë. Kur në gusht të këtij viti Turqia nisi në Shkodër mareshalin Riza Pasha në krye të 3000 ushtarëve, për të ushtruar presion mbi shqiptarët që të mos kundërshtonin dorëzimin e Ulqinit Malit të Zi, fuqitë mprojtëse u çuen peshë dhe i dolën zot qytetit. Riza Pashën e pasoi Dervish Pasha, i cili, më 22 nandor 1880, filloi marshimin mbi Ulqin, për t'ja dhanë në dorë Malit të Zi. Vullnetarët shqiptarë luftuen, por pa fryt. Më 26 nandor, turqtë e dorëzuen limanin.

Pas kësaj ngjarje, Turqia zu të ndjekë, të arestojë dhe të internojë atdhetarët shqiptarë. Komiteti i Lidhjes e shpalli vehten si qeveri «të përdorëme» (të përkohëshme), tue e përqëndruë vemendjen në organizimin e forcave ushtarake dhe në zgjanimin e pushtetit të vet nëpër krahinë të tjera. Turqia kundërveproi me dhunë. Ajo dërgoi një ekspeditë të madhe ndëshkimore dhe i ripushtoi qytetet e çlirueme nga ana e Lidhjes. Në Shtimlje, shqiptarët luftuen heroikisht, por u detyruen ma në fund të tërhiqen. Kur turqtë pushtuen Prizrendin, krenët përparimtarë të Lidhjes e caktuen qendrën në Gjakovë. Por edhe kjo u shkel nga pushtuesit e atëhere Lidhja u shpërnda me forcë. Në këto kushte të lindjes, të zhvillimit dhe të mbarimit të Lidhjes mori hov të madh kultura dhe arësimi kombëtar mbi bazën e këndim-shkrimit shqip. /

Që më 1875, përpjekje për shkollë shqipe banë në Berat K. Kristoforidhi dhe Hoxhë Tahsini. Më 1877, Th. Krei përshtati nga greqishtja një histori të Skënderbeut. Viti 1878 shenoi krijimin dhe botimin e një tufe veprash me karakter gjuhësor dhe letrar. L. De Martino shkroi vjeshën alegorike *Zogu në kafaz t'Horiatit*, frymëzue nga ngjarjet politike të kohës: zogu asht Shqipnia, horiati (koprraci) asht Turqia. Mitkua botoi përmbledhjen e famëshme *Bleta Shqiptare* dhe lëshoi në vargje thirrjen për t'u çlirue me armë në dorë. Ndërkohë J. Vretua përpiloi *Apologjinë* greqisht për të mprojtë A. Frashërin nga sulmet e shovinistëve grekë. Edhe ma i frutshëm qe viti 1879. Në Stamboll, S. Frashëri, P. Vasa, J. Vretua, etj. krijuen një alfabet të përbashkët dhe botuen një *Alfabetare*; ata ngritën, gjithashtu, *Shoqërinë e të shtypurit shkronja shqip*. Arbneshi i Greqisë, A. Kullurioti, filloi të botojë në Athinë organin *I foni tis Albanias*

(«Zëri i Arbërisë»), që e vazhdoi deri më 1880. De Rada kreu veprën *Skanderbeku i Pafaan*. P Vasa qiti në dritë poezinë luftarake *O moj Shqypni!*, që u këndue si marsh për mprojtjen e atdheut. Kristoforidhi botoi toskënisht shqipërimin e *Dhiatës së Re*. Më 1880 dalin vepra të reja. Kristoforidhi jep toskënisht shqipërimin e disa copave të *Dhiatës së Vjetër*; F. Shiroka boton në italishte vjershën *All'Albania all'armi!* («Shqipënisë në armë!») me rasën e luftës për mprojtjen e Ulqinit; në Shkodër vdes Zef Jubani, një nga të njohurit e Dorës. Më 1881, ndërsa në Bukuresht themelohet *Deg' e Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip*, që, ma vonë, u pasue nga *Drita* dhe *Dituria*, ndërsa Koto Hoxhi ndiqet egërsisht nga shovenistët grekë dhe në Greqi vdes Panajot Kupitori, L. De Martino boton në Veneti veprën e madhe *L'Arpa d'un italo-albanese* («Harpa e një italo-arbëreshi»). Viti 1882 nuk shënon ndonjë veprimtari të dukëshme letrare, veçse Kristoforidhi boton gramatikën e vet, në Itali vdes Dh. Kamarda, një nga miqtë e Dorës, dhe në Greqi A. Kullurioti. Viti 1883 gjithashtu nuk tregon hov botimesh, në fushën e gjuhës dhe letërsisë, veçse De Rada nis të nxjerrë në dritë të përkohëshmen *Fiâmuri Arbrit*, ndërsa Kozmo Serembeja ban të njohun librin e të ungjit Zef Serembes *Poesie italiane e canti originali tradotti dall'albanese* («Poezi italiane dhe kangë origjinale të përkthieme nga arbënishtja»). Ma i mbarë duket viti 1884. Në Stamboll del e përkohëshmjia *Drita*, që u shndërrue pastaj në *Dituria*, ku Naimi qiti në dritë poezitë e para; Gjerasin Qiriazit punon për një gramatikë të shqipes dhe lidhet me De Radën, ndërsa Kristoforidhi ngulet në Elbasan. Viti 1885 shënon një humbje të madhe për letërsinë arbëneshe: vdes G. Dara i Riu. Një kthesë të vërtetë letrare përban viti 1886: shoqnia *Dituria* e

Bukureshtit themelon të parën shtypshkronjë shqipe dhe me të boton vepra të randësishme, si p.sh., *Bagëti e bujqësia* dhe *Dituritë të Naimit, Shkronjëtores* e S. Frashërit, etj. Në Itali vdes V. Stratigoi. Më 1887 kemi përsëri të reja të çmueshme në fushën e gjuhës, letërsisë dhe arësimit. Më 7 mars, në Korçë, me ndihmën e atdhetarëve shqiptarë të Rumanisë, me librat shqipe të botuara atje nën kujdesin e Naimit, Samiut, etj. hapet e para shkollë shqipe. P. N. Luarasi çel në Ersekë një tjetër shkollë shqipe. Ndërsa në Palermo del e përkohëshmja *Arbri i ri*, në Brëilla të Rumanisë fletorja shqiptare në gjuhën rumune *Drita (Lumina)*, Santori boton pjesë të dramës *Emira*, kurse N. Mjeda poemthin romantik alegorik *Vaji i bylbylit*. Tablloja letrare e vitit 1888 mbyllet me botimin e fletores *Sqiptari në Bukuresht* dhe të librit të S. Frashërit *Dheshkronja*.

Në këtë kuadër plot ngjarje politike dhe kulturore shqiptare përfshihet periudha e fundit katërmëdhjetëvjeçare e jetës së Dora d'Istrias. Në Firenze, në rrugën Leonardo Da Vinçi, ajo ka blemë një madhe të kohës gjatë asaj periudhe ajo e çoi atje. Por, thuejse çdo verë, pushimet i kalonte në Rapalo, krahinë e Xhenovës. Kështu, në korrik të vitit 1876, në korrik dhe gusht 1878, në gusht 1879, e shohim në Rapalo. Për kërkime të reja a për vizita prehjeje, atë e shohim edhe në Boston të Shteteve të Bashkueme të Amerikës, në korrik 1880. Jeta e saj, që në moshë të njomë, që një shtegëtim i gjatë, një lëvizje e vazhdueshme, me ndërpreme mjaft të shkurtra në krahësim me jetët e dijetarëve dhe artistëve të tjerë të profilit të saj. Dhe, në këtë lëvizje, në këtë shtegëtim, interesimi për çështjen shqipëtare asht i vazhdueshëm tek ajo, asht pasioni ma fisnik që mbi-

zotnon në qenien e saj. Ajo ndjek dora-doras të gjitha ngjarjet me randësi politike dhe kulturore që përmendëm ma sipër, ndonëse veprimtaria e saj ka tash-ti një ramje, nuk asht ma e gjallë si në vitet 60.

«Nuk besoj se duhet me ja mvëshë Monsenit (autorit të një *Historie Romake*, V. B.) opinionin që do t'i lidhte popullsitë e bregut italian të Adriatikut me Proto-Shqiptarët. Kjo hipotezë ka qenë mbështetë nga I. Hahni. Por, si njani si tjetri, ata pajtohen për prejardhjen e Venetëve».

i shkruen më 3 korrik 1875 nga Firenze De Radës. Dhe, po nga Firenze, ajo e ven në dijeni poetin se po punonte «...mbi poezinë e kombeve (fiseve, V. B.) turke» kërkime të fillueme në Veneti dhe që do të dëshëronte t'i përfundonte atë vit.

Midis miqvet të Dora d'Istrias ishte edhe një mbret: Pedro II i Brazilit, i hypun në fron më 1831 dhe i ramë nga fronti më 1889. Ishte kv monark, pra, tri vjet ma i moshuem se Dora. Ishte i ditun dhe e çmonte shumë dijetaren tonë. Te ky sundimtar Dora rekomandoi poetin arbënesh Zef Seremben. Poeti i ri nga Strigari i Kozencës qe dashunue me një fshatare të thjeshtë arbneshe dhe kësaj ja pat kushtue poezinë e butë të zemrës *Kangjela e mallit të parë*. Mirëpo, vasha e zgjedhun, bashkë me t'anë, emigroj në Brazil, ashtu sikurse qinda arbëneshë dhe mija italianë, që shkonin e shkojnë tej e tej në kërkim të punës për gjallim, kur këtë s'e gjenin e s'e gjejnë dot në vendlindje. Vasha vdiq atje dhe Zefi vajti më 1875, kur ishte tridhjetedyvjeçar, pasi kishte krijuë disa nga lirikat ma të bukura intime, atdhetare dhe shoqnore. Por poeti i ri nuk gjeti qetësi dhe prehje aty, në oborrin mbretnor. Aristokracia braziliene, me

jetën e vet të shfrenueme, pas qejfeve, me tekat e veta, shkëlqimin e jashtëm dhe puthadorjen, prishjen e moralit dhe kotësinë, nuk e tërhoqi, nuk e prehu. Përkundrazi, në një letër që i dërgoi De Radës, ai shprehu nëveri ndaj saj. Pati atje një lidhje intime me një braziliane, por kjo përfundoi me të keq dhe ja bani të padurueshëm qëndrimin e matejmë në oborrin mbretnor, pa u mbushë ende moti i parë.

Më 1876, Dora d'Istrian e josh shpresa se Shqipëria jo vetëm do të çlirohet, por edhe do të bahet vendi i lëruesve të zotë të tokës:

«Le të jetë» toka e trimave dhe e shpirtëve të papërkulun» (Bajron) gjithashtu atdheu i lëruesve po aq të gjallë dhe po aq të squetë për ta bamë pjellor këtë truell të lamë me gjak shekuj me radhë!»

i shkruen De Radës nga Rapalua, më 16 korrik 1876. Po në këtë letër ajo i rrëfen, për një vlerësim të madh që i asht bamë nga princi i Rumanisë, tue i dhanë urdhënin «Bene Merenti» të shkallës së parë:

«Memzi kam pasë kohë të gjej një ças për t'iu përgjegjë princit të Rumanisë, që më dërgoi urdhënin e shkallës së parë të «Bene Merenti» dhe, megjithatë, asht hera e parë në Perëndim, sikurse edhe në Lindje, që një grue fiton një dallim të kësaj fare, rezervue vetëm për dijetarë».

Ky çmim iu dha asaj në kohën kur në Rumani ishte në fuqi qeveria liberale e Emanoil Kostaqe Epu-reanu-s. Në këtë vit, ajo ende i përmbahet mendimit se shqiptarët, tue besue se janë pasardhës të pellasgëvet, duhej të lidheshin në një front të përbashkët

me «latinët» dhe «helenët». Në letrën që i dërgon De Radës nga Firenze më 7 nandor 1876, i thotë:

«Me që bashkatdhetarët e Skander-begut janë pellazgë, ata nuk duhet të harrojnë se familjes së shkëlqyeshme pellazgjike i asht dashitë të mprojë vendin e gjyshave të vet, si kundër fitimtarëve të sllavë ashtu edhe kundër sulltanëve. Shqiptarë, latinë dhe helenë do të bajnë mirë mos me nxjerrë gështenjat nga zjarrri për një perandori pansllaviste dhe të kujtohen se si Austria naive ka dhanë në Shlesvig-Holshtaj një edicion të ri të komedisë së Bertrandit dhe Ratonit. . .»

Shihet qartë se atdhetarja jonë e shqueme nuk pajtohet, si këtu si kudo, me asnjë farë shovinizmi, ngado që të vinte dhe kushdo që ta çfaqte. Ndërkohë, ajo vazhdon të nxjerrë në pah kontributin shqiptar në kulturën e popujve të tjerë. Po lexojmë letrën e saj dërgue nga Firenze autorit të Milosaatit më 7 nandor 1876:

«Zia-beu nuk asht i vetmi poet që Shqipnia i ka dhanë perandorisë turke. Jahja-beu asht njani nga të dhjetë poetët e mëdhej të kohës së artë. Disa nga Qyprylljtë, miq të të parëve të mi, lëronin, gjithashtu, poezinë. Falë atyne, Turqia pati, në shekullin XVII, një rilindje të vërtetë letrare dhe politike njëkohësisht. Kjo dinasti e fuqishme vezirësh të mëdhenj mundi të bajë me besue një ças që era e lavdishme e Sulejmanit të Shkëlqyeshëm po lindte përsëri».

Tue përsëritë disa mendime të shprehuna ma parë dhe të përbashkëta me ato të kushërinit të vet, Joan

Gjikës, ajo thekson se zgjimi i jetës intelektuale asht burim i gjithë veprimtarisë shoqnore dhe i gjithë përparimit të vërtetë:

«Im kushëri Ioan, për të cilin ju më flisni, Zotni, në letrën tuej të fundit — i shkruen De Radës nga Firenze më 14 dhjetor 1876 — asht një nga ata që e kanë kuptue ma mirë se kushdo tjetër që gjaja e parë për t'u bamë në Lindje (Ballkan, V. B.) nuk asht me u lëshue në thirrje a çfaqje shumë a pak «atdhetare», por me zgjue jetën intelektuale, burim i gjithë veprimtarisë shoqnore dhe i gjithë përparimit të vërtetë».

Ajo vazhdon ta vejë në dijeni poetin për përhapjen e veprave të veta nëpër vende të ndryshme:

«Një tjetër përkthyes, Z. Peretz, — shkruen ajo me 10 qershor 1877 — fillon në Bukuresht botimin e një përkthimi rumun të veprave të mia. Vëllimi i tretë ka dalë në dritë tashma».

Vitin 1877 ajo e mbylli me editimin e dytë të veprës *La poésie des Ottomans* («Poezia e Otomanëve»), në Paris, tue dëshmue me 'të se po vazhdonte studimin e kujdesëshëm të kangëve popullore të popujve lindorë, fino-mongolëve, etj.

Tashti ajo ka arritë moshën pesëdhjetëvjeçare, ka krijuë një radhë veprash artistike dhe diturake, asht bamë shumë e njohun ndër rrethet letrare dhe asht kunorëzue me larin e mirënjohjes dhe lavdisë nga ana e shumë vendeve të botës për kontributin e saj të dhanë në dobi të çështjes së çlirimit të kombësive. Në përfytyrimin e opinionit publik botënor, si-domos tek ata popuj, në gjuhët e të cilëvet u sollën

veprat e saja, Dora d'Istria u ba «kampioni i palodhëshëm i çështjes së kombësivet»; siç e thotë Larousse-i, fjalori universal i frengjishtes, u ba ajo që hodhi dritë mbi çështjet landore dhe jetësore, të cilat kanë lidhje me të ardhmen politike dhe shoqërore të ballkanasve. Ndokush deshi ta përfillë Dorën misë të asaj kombësie së cilës i përkiste ai vetë. Disa studimtarë nisën e thanë se ajo duhej të ishte frenge, sepse edukatë të tillë kishte ndër shkrime të veta dhe sepse, bile, në frengjishte i shkruante veprat; të tjerë folën për edukatë gjermane të saj, rumune, greke, ruse. Pra, sipas tyre, ajo mund të ishte kombësie gjermane, rumune, greke, ruse. Jo. Dora d'Istria ishte lindë Elena Gjike në Rumani, ishte martuar me një rus në Rusi, kishte fitue me nderim të posaçëm natyralizimin grek dhe urdhënin rumun si dijetare, ishte bamë anëtare nderi, shoqe a pajtore e shumë shoqnive dhe shoqatave kulturore, artistike dhe diturake të vendeve të ndryshme të botës, ishte ngulë përgjithnjë në Itali, shkruante ma fort në frengjishte, por nuk e kishte shpallë vehten as rumune, as ruse, as greke, as italiane. Ajo e ndjeu vehten vetëm e vetëm shqiptare dhe të tillë e shpalli vehten me mburrje të ligjëshme. Mirë pat shkruar që më 1866, në *Saggio Biografico su Dora d'Istria*, përkthyesi në italishte i veprës së saj *La nationalité Albanaise...*, E. Artomi:

«...karakter bujar, sikurse edhe squetësi fisnike, ajo nxjerr në pah me qenien e vet atë tip të ngultë dhe të njerëzishëm që asht në trashëgimitë e pamvaruna të shqiptarëve të familjes së saj». ²⁾

Edhe P. Mantegaca, që u ndal në mënyrë të veçantë te fytyra e ndritëshme e Dorës si te një nga më të shquemet gra të botës, vuni në dukje:

«...Dora d'Istria nuk mveshi uniformë kombësie, nuk mbarti petk tjetër përveç atij të një qytetari të botës civile, pa mohue megjithatë as atdhe as vendlindje». 3)

Në të vërtetë, ajo nuk mohoi as atdheun e të parëve, Shqipninë, as vendlindjen, Rumaninë. Por mbeti deri në fund shqiptare. Dhe mbeti një shqiptare e flaktë si mprojtëse e kombësive dhe përkrahëse e popujve të vegjël, kundërshtare e furishme e tiranëve dhe e tiranisë, e shovinizmit dhe e shovenistëve. Më 27 prill 1878, ajo i shkroi De Radës nga Firenca, tue i theksue se për shefat e kombeve e mira e popujve çonte ma pak peshë se sa interesat e ngushta dinastike ase thjeshtë vehtjake.

Erdhi qershori i vitit 1878. Me zemrim të madh ajo mori vesh vendimet e padrejta të Kongresit të Berlinit kundër disa popujve të Evropës jugë lindore, sidomos kundër popullit të vogël shqiptar. Në letrën e 17 korrikut 1878, ajo i shkruen mikut të madh, poetit të mplakun të Makjit, por të palarguem nga sheshi i fushatës politike, kundër Kongresit të Berlinit, që shestoi copëtimin e gjymtyrëve të Shqipnisë së vogël. Nga Rapalua, me 26 gusht 1878, ajo përkrah Lidhjen e Prizrendit, kurse, pas gjashtë muejvet, nga Firence, pikërisht më 27 shkurt 1879, ajo vëren se «Liga Shqiptare» nuk ka gjetë ende një Tadeo Koshjuzhko për pris të vet. Si dihet, ky gjeneral polak ka marrë pjesë nëpër kryengritje të ndryshme kundër sundimit carist. Me gas të madh vazhdon ta njohtojë poetin për përkthimin e veprave të saja në shumë gjuhë të botës. Kështu, më 9 prill 1879, kur çështja shqiptare u ba e përmendun si çështje e një populli të vogël, i cili po kërkonte lirinë dhe mprojtjen e tokës amtare, por që fuqitë e mëdha dhe

shovinistët fqinjë po ja mohonin, bile pleqënuen ta grabisnin, Dora i rrëfen De Radës se vepra e saj po përkthehej edhe në gjuhën e ma të madhit popull të Azisë, në gjuhën kineze:

«Ndërsa Z. Mitlo ishte i zanë, në Kajro, me përkthimin (e një vepre të saj, V. B.) një letrar nga Tien-Cin, Çok Vong, përkthente disa nga shkrimet e mia në gjuhën e Konfuçit».

Po atë vit, më 16 qershor, ajo e ban me dijtë De Radën se po vazhdonte studimin e tregimeve shqiptare dhe shpreh dëshirin që të dalë një shqiptar dhe t'i mbledhë ato, ashtu sikurse doli rusi Athanasiev:

«Kam ndjekë ditët e fundit studimin e tregimeve shqiptare dhe jam magjepsë gjithnjë e ma shumë. Do të ishte për t'u dëshirue që një shqiptar të bante për këto tregime ato që rusi Athanasiev ka bamë për tregimet e perandorisë së carëvet».

Në një letër të dërgueme nga Rapalua më 9 gusht 1879, ajo i shpreh mendimin poetit se:

«asht e vështirë me ia mvëshë Austrisë një politikë shqiptarofile».

Në korrik 1880, e shohim në Shtetet e Bashkueme të Amerikës, në të përkohëshme të të cilit vend ajo kishte nisë të bashkëpunonte kohë përpara. Në letërën e 31 korrikut 1880, ajo i shkruen De Radës nga Bostoni (Massachusets), ku i tregon se sa mirë e kishte pritë poeti i madh amerikan H. V. Longfellow.

E kishte ftue për drekë dhe i kishte premtue se së shpejti do të krijonte një poemë mbi Skënderbeun:

*«...poeti i madh Longfellou, që më
ftoi pardje për drekë, më ka premtue
se së shpejti do të krijojë një poemë mbi
Skënderbeun».*

Poeti ishte plak tetëdhjetëvjeçar, Dora jonë pesëdhjetenjë. Si dihet, Longfellou e hartoi poemën e njohun *Kthimi i Skënderbeut në Krujë* mbi motivin e marrjes së fermanit me pahir nga Gjergj Kastrioti prej dore së një qatipi, pas thyemjes së ushtrisë turke në fushatën e Nishit. Duket se ky poet i shquem u mbështet tek vepra barleciane për të krijuar poemën në fjalë. Kjo që dëshmon artistja jonë në letrën e përmendun, ndodhi dy vjet pas Lidhjes së Prizrendit, dy vjet para se të vdiste poeti amerikan dhe tetë vjet para se të mbyllte sytë ajo vetë.

Mbasi kaloi vera dhe zu fillin vjeshta, mendarja jonë kthehet në Firence. E mbushun me gëzim për ngjarjet shpresëdhënëse të «Ligës Shqiptare», ndonëse tanët po luftonin midis dy zjarrevet — turqvet shkelës dhe shovinistëve malazezë, serbë dhe grekë — ajo merr dhe i shkruen poetit gjashtëdhjetegjashtë vjeçar të Makjit, më 6 nandor 1880:

«Gëzohem gjithashtu me gjithë zemër tek shoh se punët e Shqipnisë po marrin udhë në mënyrë të kënaqëshme. Nuk dyshoj se, tek e mbramja, ky popull trim do të tregohet i denjë për vetvehten. Ç'heroizëm dhe ç'karakter! Tue pritë kënaqësinë që të ju shtrëngoij dorën një ditë në Shkodër, ju lutem,

Zotni, pranoni përshëndetjet e mia vëllaznore».

Më 2 prill 1881, ndërsa turqtë po ndiqnin, arrestonin dhe internonin atdhetarë shqiptarë, Leonardo De Martino, prift arbnes, mësues dhe poet, i dërgoi nga Shkodra këtë homazh në vargje italisht, të cilat po i sjellim lirisht në shqip:

*Shkrimtares së ndritun
Princeshës Dora d'Istria*

*Thonë se je bujare, e mirë dhe e bukur,
se e ke zemrën të madhe si të një gjenie;
Bijë herojsh, por prap motra jonë;
Thonë se gjenia jote asht e denjë për një
skeptër.*

*Nga një anë e botës në tjetrën kështu flasin.
Dhe në zemrat e shqiptarëve ti mban një
mbretni;
Po ne, që na mungon një skeptër i artë, një
Fron...*

*Një pendë të argjandë të dërgojmë si dhuratë.
Asht një dhuratë e vogël, vërtetë, por
dëshmon*

Se sa të don dhe të çmon çdo shqiptar! 4)

Ky homazh në vargje u shoqnuë nga treqind nënshkrime të nxanëseve shqiptarë të Shkodrës dhe nga një pendë e argjendë, punim filigrane i mjeshtrave shkodranë. De Martino shenonte:

*«Vajzat e sipërthana, thuejse në emën
të të gjitha gravet shqiptare, për të cilat
bashkëkombtarja e tyne e shqueme shkroi*

shkëlqimisht, tue i kushtue këtë homazh të thjeshtë, deshën t'i shoqënohen korit të burrave shqiptarë të Shqipënisë dhe të Epirit të kolonive arbëneshe të Italisë, të Greqisë dhe të ishujve jonianë, të cilët, që më 1870, i kishin paraqitë një tufë lulësh poetike, të shprehuna në dialektet kryesore të gjuhës amtare dhe të botueme në një vëllim të bukur në Livorno, me qëllim që me i dëshmue autores së Kombësisë Shqiptare, asaj që ata e quejnë «Ylli i Shqipënisë», admirimin, evarinë dhe dashurinë që ushquejnë për të». 5)

Dora d'Istria, më 4 maj 1881, nga Vila d'Istria, Rrugë Leonardo Da Vinçi të Firencës, iu përgjigj me këtë letër De Martinos:

«Tue u kthye nga një eskursion, në Itali, gjej poezitë tueja dhe letrën tuej të dashun. Shpejtohem t'ju thom se unë ju pres me andje dhe se do të jem e lumtun të marr në dorë pendën që më dërgojnë bijat e shtrenjta shqiptare». 6)

De Martino, pasi i dërgoi pendën dhe poezinë, tregon jehonën që shkaktoi në botën e huej ky gjest mirënjohjeje:

«Folën fletore të ndryshme të Italisë, të Francës dhe të vendeve të tjera. Mjafton me sjellë për këtë punë shënimin që vijon, marrë nga Gazzetta di Venezia, 10 qershor 1881, Nr. 153: Lexohet në Nazione të Firences: «Shkrimtarja e famëshme prince-

shë Dora d'Istria, që tash sa vjet jeton midis nesh, ka marrë dhuratë nga Shqipëria një pendë të argjandë, dërgue si homazh nga disa qindra vajza të popullit. Kjo pendë asht një punim i mrekullueshëm në filigranë, prodhim i hollë, në të cilin shqiptarët patën gjithmonë mjeshtra fort të lavduem... Dora d'Istria ka mprojtë me elokuencë të ngrohtë kombësinë shqiptare». 7)

Më 8 qershor 1881, prap nga Firenca, Dora i dërgon një letër të dytë L. De Martinos, i cili gjindej në Veneti, ku i shkruen:

«E kam marrë krejt me kohë pendën e bukur të shqiptareve të mia të shtrenjta, që unë do të doja, një ditë, të mund t'i përqafoj. Ma e fuqishme se një skeptër, uroj që kjo pendë, deri në frymën time të fundit, të përdoret për të mprojtë nderin dhe të drejtat e Shqipërisë, atdheut tim të nderuem. Njëkohësisht, vij t'ju falënderoj për mirësin tuej. Do të lexoj me një interesim të vërtetë «Un fiore» («Një lule»), që asht një kujtim i një prej njerëzve tanë vdekë në moshë fare të re, por shembull i të cilit do t'i shërbejë ende brezit të ri, që e ka për detyrë të punojë për ringjalljen e Atdheut». 8)

Gazzetta di Venezia shenonte ma tej, tue riprodhue lajmin nga Nazione e Firencës:

«Princesha Dora d'Istria shkoi nga Athina në Gjiun e Patrasit për të vumë kunora

mbi varret e Xhorxh Bajronit dhe të Boçarit. Pas udhëtimit të saj tash vonë në Shtetet e Bashkueme, princesha Dora d'Istria asht bamë bashkëpunëtore e ngushtë e revistave dhe e të përkohëshmeve amerikane, në të cilat artikujt e saj kërkohen dhe lexohen me etje. Kështu e kalon ajo kohën që i tepron nga kujdesi vërtet i pasionuem dhe i vazhdueshëm kushtue koleksioneve të veta të shkëlqyeshme të luleve». 9)

Tashma, ajo ka fillue të thyhet në moshë, nuk ndërmerr udhëtime të gjata, nuk shtyhet ma në kërkime të thella arkivale, nuk u shkruen ma letra të shpeshta dhe të gjata miqve, por jepet pas punimesh të lehta të tokës që ka rreth e qark vilës dhe, sidomos, pas mirërritjes së luleve. Ajo asht bamë një koleksioniste e rrallë lulësh. Herë pas here, vihet dhe u shkruen miqve të shtrenjtë e, në letrat e veta, nuk mungon të shprehë, si përherë, shpresën e ambël për ditët ma të bardha të Shqipnisë, atdheut të vet të nderuem, siç thoshte ajo vetë. Ja se ç'i shkruen De Radës nga Firenze më 5 shtator 1883:

«Due të besoj se flamuri i Shqipnisë do të marshojë ngadhnjmtar dhe do të arrijë një ditë mbi majet e Shkodrës si fitimtar dhe si një udhëheqës bamirës».

Dhe, katër vjet ma vonë, më 7 janar 1887, si gjithnjë e përpiktë, e njerëzishme dhe e prushme me poetin e madh arbnes, i shkruen:

Le drapeau à croix rouge
Drapeau de l'Allemagne marchera
Triomphant et arrivera un
jour sur les sommets de
Sion en vainqueur et
comme un guide triomphant.

Yves d'Alton

«Zotni, më duket se më keni kërkue
një ditë adresën e Z. E. Mitkos.

Ja: Beni — Suef (Egjipti i epër).

Përshëndetjet e mia vëllaznore,

Dora d'Istria»

Asnjë herë nuk i kishte shkruar kurrë, me
dorë kurrë të dridhur. . . Po afrohej fundi i jetës së saj.

«Dhe kur nga dita o nga salla e bi-
sedës — shënonte P. Mantegaca — ajo kthe-
hej në dhomën e vet të studimit, dhe pasi
ka jetue me lule dhe me njerëz e sheh
vehten të radhitun përballë vëllimevet të
veta, ka të drejtë të çojë kokën lart, tue
pëshpëritë me vehte me gëzim të përlligjun
fjalët e të vjetrit: «Non omnis moriar»¹⁰)

Po, nuk do të vdes krejtësisht, si ka thanë Horaci
në Odet e veta, sepse vepra ime do të më pasojë —
kështu vërtet na duket se do të ketë thanë me vehte
ajo në vetëminë e dhomës së punës, larg atdheut
të të parëve, me shpresë e besim se mirënjohja e
atyne, të cilëvevet u kish sjellë aq të mirë me fjalën
e vet prej dijetareje dhe artisteje, do të mos ndry-
hej nën rrasën e varrit të ftohtë, por do të ngrihej
e shumëngjyrëshme si lulet e rrituna prej saj me
aq kujdes dhe dashuni.

Elena Gjika mbylli sytë në Vila d'Istria, rruga
Leonardo Da Vinçi të Firences, më 20 nandor të
vitit 1888, në moshën pesëdhjetenandëvjeçare.

Nandë vjet ma vonë, tue përkujtue fytyrën e
saj, me të drejtë shkroi mikja dhe shoqja e saj e
pandame, poetesha e njohun vjeneze Jozefina Knorr:

«Prej gurre fort të kulluet shqiptare,
e shtrenjtë për shqiptarët, krejt kushtue
çështjes së tyne, ajo asht e denjë për
nderimin që po i baj unë këtu». ¹¹⁾

1. U.Sh.T: I.H.Gj. *Historia e Shqipërisë* (Maket për diskutim).

2. sp: Fishta F.: *Dora d'Istria*, po aty f. 247.

3. sp: Fishta F.: *Dora d'Istria*, po aty, f: 243:

4. D Martino P.L.: *L'arpa d'un italo-albanese*, Venezia, 1881, f: 82.

5. De Martino P.L.: *L'arpa d'un italo-albanese*, po aty, f. 166.

6. De Martino P.L.: *L'arpa d'un italo-albanese*, po aty, ff. 166-167.

7. De Martino P.L.: *L'arpa d'un italo-albanese*, po aty, f: 167

8. De Martino P.L.: *L'arpa d'un italo-albanese*, po aty, f. 119

9. De Martino P.L.: *L'arpa d'un italo-albanese*, po aty, f. 119

10. Sp: Fishta F.: *Dora d'Istria*, po aty, f. 250.

11. Knorr Giuseppina Baronessa: *Un ricordo a Dora d'Istria*, në *La Nazione Albanese*. Anno I, 15 janar 1897. Nr. 1, f. 1

KAPITULLI I GJASHTË

P E R J E T E S I M I

«Afër qiellit hiadhiarë
T'Arbëreshëvet e mjerë,
Nj' il i bukur u fanarë
Që largon natën e gjerë».

Zef Serembe

Asht e vështirë me sjellë këtu gjithçka u shkruie për Elena Gjickën nëpër botë. Po kufizohemi vetëm me disa gjykime të dhana për fytyrën dhe veprën e saj nga studimtarët e huej dhe shqiptarë, për të gjallë të saj dhe pas vdekjes. Që më 1864, në Bukuresht u botue vepra e Armand Pomierit *Profile contimporane — Doamna Contessa Dora d'Istria* («Profile bashkëkohore — zonja konteshë Dora d'Istria»), në të cilën lartësohet fytyra e saj si një nga ato që shquheshin në atë kohë në radhën e grave europiane, aq sa Garibaldi ta quente «motër heroike». Një vlerësim të bukur i bani asaj përkthyesi i veprës *La nationalité albanaise...* në italishte, E. Artomi, më 1867. Një kujdes të veçantë për përhapjen dhe studimin e veprimtarisë dhe krijimtarisë së saj tregoi paleografi venecian, drejtori i Arkivit Shtetnor të Venetisë, Bartolomeo Çeketi, i cili, më 1869, në veprën *Dora d'Istria e la poesia albanaise* («Dora d'Istria dhe poezia

shqiptare»), jep një përshkrim të shkurtën të dijetares dhe një listë të veprave të saja, botue deri atëherë. Krahas disa gjykimeve të shprehuna mbi shkrimtaren nga artistë dhe dijetarë të ndryshëm të botës, Çeketi na jep një ide që ka nxjerrë nga bibliografia e shkrimeve të saja, tue shenue se deri në atë kohë ajo kish botue mbi 150 artikuj, studime, monografi, broshura dhe libra të ndryshëm rreth artit, ekonomisë politike, historisë, filozofisë, folklorit, si dhe tregime, përshkrime, mbresa udhëtimi. Në shenjë nderimi dhe mirënjohjeje për këtë kontribut, J. De Rada i kushtoi një poezi këtij studim-tari italian të dijetares sonë, botue së pari në *A Dora d'Istria gli Albanesi* («Dora d'Istrias Shqiptarët»), më 1870, ribotue pastaj në *La Nazione albanese* e A. Lorekjos, më 31 mars 1897, me titullin *Ode ad un ammiratore di Dora d'Istria* («Ode një admiruesi të Dora d'Istrias»).

«Ajo ka mbledhë, të ilustrueme, kangë piktoreske popullore nëpër artikuj të botuem në Revue des deux Mondes, që ngjallën simpatitë e Evropës edhe sot e kësaj dite me origjinalitetin e tyne poetik».

shkruante *Gazzetta di Venezia* e 10 qershorit 1881 ¹⁾.
Jetëshkruesi freng E. Deshanel, shenonte në *Débats*:

«Për lumtuninë e një njeriu do të ishte e mjaftueshme çdo vepër, e marrun veç, që doli nga penda e kësaj gjenie». ²⁾

Enriko Pancaki e krahason me dy shkrimtaret frenge, Zhorzh Sandin dhe Konteshën d'Agui, tue vumë në dukje edhe dallimin që e shquen shkrimtaren tonë prej tyne:

«Vendi i saj çfaqet shumë qartë midis Zhorzh Sandit dhe Konteshës d'Agu, për atë që zjarmitë e përtëritjes shoqnore që ndiznin zemrën e së parës dhe shkëndijimet spekulative mendjen e së dytës, te Dora d'Istria theksohen, më duket mue, për t'u harmonizue dhe për të marrë një drejtim ma veprues e të përfitueshëm, falë virtytit të një intelekti ma të qartë dhe të një karakteri ma të ekuilibruem». 3)

Paolo Mantegaca, në veprën *Fisiologia della donna* («Fiziologjia e grues») shkruen:

«Ajo asht ndoshta e vetmja grue që i ka gjykue me drejtësi simotrat e veta». 4)

Gjetkë, tue karakterizue profilin e saj si shkrimtare, Mantegaca vazhdon:

«Librat e Dora d'Istrias janë ndër ata të rrallët që përmbajnë mendime dhe bajnë të mendojnë edhe të tjerët. Në çdo rasë, në të lexuem, shihet nevoja me i shenjue fjalitë e saja, të shpërndame nëpër fletët e ndryshme. Lexuesi, që don të mendojë me 'të, gjen gjithkrah te Dora njohuni të shumta, fitue nga leximi i libravet. Tek ajo vërehen frytet e një përvoje të shëndoshë, e cila nxirret vetëm nëpër udhëtime të bame me dobi. Nga xanesa e çështjeve të veçanta ajo kapërren përherë ndër çështje të përgjithëshme e, ma e vogla dhe ma e lehta ore e një ngjarjeje zhvillohet nga ajo ma së miri, mbasi në të gjindet një

mendje e kthielltë, ushqye nga studimet e rregullshme dhe të kthiellta. Për gjithçka ke rasë të kënaqesh me të. Ke para vehtes sate një zemër grueje, e cila i ndien të gjitha rrahjet e zemrës dhe të gjitha valët e ndiesisë, ke para vehtes atë filozofe, e cila analizon dhe gjykon me drejtësi. Aty-këtu në grumbullin e mendimeve të saja aq të zgjedhuna e plot mprehtësi, ti ndeshesh nganjëherë në një humorizëm plot melankoli që dallohet në pendën e asaj, e cila pa dhe fali edhe tepër. Ajo vëren shumë, vëren gjithçka dhe, pasi të ketë vërejtë gjithçka, në këtë rasë, shumë ma tepër se disa mendimtarë historianë, nuk ngutet të bajë teori dhe të paraqesë dogma». ⁵⁾

Karlo Taliavini, në *Enciclopedia Italiana*, në mënyrë të përmbledhtë, ban këtë karakterizim për të:

«Si shkrimtare, veprimtaria e saj qe shumë e madhe, veprat e saja ndihmuen në mënyrë të shenueme për të bamë me njohtë në Evropë letërsinë popullore, doket dhe historinë e Evropës Lindore». ⁶⁾

Një vlerësim të mprehtë i ka bamë stilit të saj *Larousse-i*, fjalori universal i frengjishtes:

«Stili i saj asht i gjallë, pa qenë i lehtë, i ngultë dhe i ngjyrëshëm». ⁷⁾

Më 1931 dolën dy vepra të kushtueme dijetares sonë nga dy studimtarë rumunë: *Dora d'Istria* e M. Ioanit

dhe *Dora d'Istria* si *Edgar Quinet* («*Dora d'Istria* dhe *Edgar Kiné*») e I. Breazut. Një vit ma vonë, për të parën herë, historiani i madh arumun, *Nikolaj Iorga*, botoi një pjesë të epistolarit të saj nën titullin *Letres de Dora d'Istria* («*Letra të Dora d'Istrias*»). Tue u ndalë te fytyra e saj për ndihmën e dhanë çështjes shqiptare, studimtari i njohun arumun i marrëdhënieve gjuhësore shqiptare-rumune, *Teodor Kapidani*, shkruen:

«Erdhi një kohë kur midis dijetarëve të huej filloi një rrymë për studimin e gjuhës dhe të letërsisë popullore shqipe... atëhere kur bija e qeveritarit Mihajl Gjika, e njohun si shkrimtare me pseudonimin Dora d'Istria (Elena Gjika), të cilën shqiptarët e asaj kohe e quenin «Ylli m'i ndrituri pas qiellit të së varfërës Shqipëri», botoi në dhe të huej një seri studimesh ndër ma interesantet në lidhje me popullin shqiptar». 8)

Veprat e saja, shkruen kryepari në frengjisht, u përkthyen dhe u botuen në shumë gjuhë të hueja: italishte, arbnishte, gjermanishte, greqishte, rumanishte, rusishte, anglishte, gjuhën kineze, etj.

Gjatë shtjellimit të jetës së saj, na patëm rasë të takohemi me vlerësime dhe karakterizime të ndryshme, që dijetarë a studimtarë të huej frengj, italianë, gjermanë, rumunë, etj. i kanë bamë; patëm rasë, gjithashtu, me pamë, jo pa ndjenjë krenarie të ligjëshme për një bashkatdhetare, se në sa shumë shoqni dhe shoqata të huaja që zgjedhë ajo si mise, anëtare, shoqe a pajtore. Na, tashti, po ndalemi vetëm te mirënjohja dhe evaria shqiptare ndaj saj.

Përkrahja e fuqishme dhe popullarizimi i madh që i bani ajo çështjes së lirisë dhe kulturës sonë kombëtare u çmuen dhe u vlerësuen shumë që për të gjallë të saj nga njerëzit e ditun shqiptarë.

«Ky emën — shkruente Dhimitër Kamarda në *Shtojcën e Gramatologisë* së vet — asht një nder i madh për botën shqiptare, së cilës ka lavdinë t'i përkasë, nga origjina e familjes së saj, një nga letraret e gjalla ma të shqueme të Evropës, e cila me bujarinë e farës dhe me cilësitë e çmueshme të seksit të bukur, mundi të bashkojë kultin ma të frytshëm të shkencave dhe të letërsisë; pra nuk len rast pa i ndihmue, me vepër, kombit shqiptar, i cili ja di për të mirë gjithmonë». ⁹⁾

Nderimin ma të madh e mirënjohjen ma të thellë ja shprehën asaj përfaqësues të vendit dhe të kolonive shqiptare, kur, më 1870, nën kujdesin e Dhimitër Kamardës, botuen në Livorno përmbledhjen poetike *A Dora d'Istria gli Albanesi* («Dora d'Istrias Shqiptarët»).

«Një komb, i cili përftoi në kohën tonë këtë kryevepër të gjallë, që asht princesha Dora d'Istria, nuk mund të quhet i vdekun dhe as mund të jetë i dënuem me mbarue».

shkruente *Rivista Europea*, ¹⁰⁾ tue u ndalë te roli i saj në çështjen shqiptare. Që më 1868, Leonardo De Martino i kushtoi përkthimin shqip të vjershës së Tomazo Grosit. Po atë vit, Zef Jubani, nën titullin *Begtareshës*, i thurte vargje si këto:

*Ti je një hyll e po na shndrit Arbnin
Me dije, me të mira e bukuri;
Me dashtni t'ande je kah na përtrin
Një gazmend të madh e një lumni...
Sielli syt tu, e mos harro kët dhë!
Të kesh edhe për ne të madh dëshirë! 11)*

Një tjetër shkrimtar dhe atdhetar nga Shkodra, Preng Doçi, i mshehun nën pseudonimin «Një djalë prej Shqypniet», shkruente për Dorën më 1869:

*Prej Istriës s'lume një trimnesh' ka dalë,
E ty t'nderon, Shqypni, si vajz' e dëjë.
Vên buzën n'gaz për te, dhe i em!..*

Dhe, ma tutje, tue iu drejtue asaj me një thirrje për një përkrahje të matejme të çështjes shqiptare:

*Ip dorën, ip Shqypnis, e nalta Dorë!
Do t'çohet prap prej baltet, do t'lulzojë...
Ip dorën, Dorë, gjind's s'ate. Një kunorë
Po t'falim na, po t'njohim t'gjith' për Zojë*

Atdhetari dhe folkloristi i mirënjohun Korçar, Eftim Mitkua, shkruente më 1869 nga Kajrue se Dora qëndronte në plejadën e herojve legjendarë krahas Pirros, Aleksandrit, Skënderbeut:

*Një shinan¹²⁾ për Shqiprinë e një nam të madh
për jetë
Zonjë Dorë Istriade! Ky i bukuri jyt' emër
Ndë Shqipëri do të jesë, bres pas brezi, mun ndë
zemër,
Bashkë me Pirron, me Ksandrin, me Kastriotin sërë.
Kurora e pavenitur për një ballë t'është' bërë.*

Po atë vit, Jani Pema, nga Korça, kujton ndihmën e saj për zgjimin e grues shqiptare:

*Zgjove çupat e i ljevdove,
Një të drejtë u rrëfeve;
Shumë herë i qertove,
Që të hapim syjtë neve.*

*Fjaljët tënde të vërteta
Shqipëtari i ndëgjon
Po ç'të bënë, kur e shkreta
Skllavëria e mundon?*

Një vit ma vonë, më 1870, arbëneshi nga ishulli Hidra i Greqisë, Gjergj Driva, dëshmon evarinë që kanë ndaj saj arbneshtët e atyne anave:

*Nidra, patridheza ime, tuti të kanë për mëmë;
Me karave kur çajnë denë, ka mendi nëke të ljenë.
Shumë kopose ke vënë për të çonjesh istorinë,
Tragjikatë e trimëritë, t'Arbëreshëvet që u vinë. 13)*

Në korin e atyne zaneve nga atdheu, nga arbneshtët dhe nga kolonitë shqiptare të Misirit, bashkohen edhe zanet e kangëtarëve në shenjë të kohës midis arbneshtët të Italisë. Zef Serembeja, të cilit Dora d'Istria ja ngjiti dorën e përkrahjes për talentin dhe ndjenjën e flaktë atdhetare, i ngriti një himn të vërtetë, më 1870, mprojtëses së vet me vargje si këto plot shpresë në të ardhmen e Shqipnisë:

*Afër qiellit haidhiarë
T'Arbëreshëvet e mjerë,
Nj' il i bukur u fanarë
Që largon natën e gjerë. 14)*

F. A. Santori, më 1870, pasi shpreh dëshirin që toskë e gegë të bashkohen, i drejtohet Dorës me thirrjen për t'i ndihmue shqiptarët që të zhdukin errësinën dhe të ndriçohen nga dija:

*Zonjë formadhe, të duronjin,
Mos nga do, pre më tutje
Ata vlezër, që gjelonjin
Përtej detit, e bëj të hinjin
Nd' errësir, e bëj të hinjin
Embëljisht të zân ndë karta
Posi Athena u madh e Sparta. 15)*

Po atë vit, Zef Kamarda i kujton Dorës se gjaku, që i rrjedh ndër dej, asht gjak shqiptar:

*E na thua se gjak arbresh
Brënda kurmit bukur ke;
Përandaj me gzim ti kjeshe
E në helme kla me ne.*

Dhimitër Kamarda e quejti, në mënyrë të mprehtë:

*«Unazë e qytetnimit, midis Lindjes
dhe Perëndimit». 16)*

Një vit pas daljes në dritë të vëllimit *A Dora d'Istria gli Albanesi*, biri i Jeromin De radës, Zefi, i kushtoi Elena Gjikhës *Gramatikën* e gjuhës shqipe. Këto shprehje nderimi për punën e saj të mirë për ç'htjen kombtare vazhduen edhe ma vonë. Shqiptarë e mërguem në Rumani, ashtu si vëlleznit e tyre atdhetarë nëpër vende të tjera, e ruejtën për kujtim të çmueshëm fytyrën e saj, e përfillën si një lidhje të tyre me

atdheun e të parëvet. Prandaj bashkë me kushërinin e saj, ekonomistin dhe memorialistin e shquem Ioan Gjika, ajo figuron si anëtare nderi, post mortem, në kryesinë e nderit të shoqnisë *Drita*, që më 1892. Me të drejtë, një pendë shqiptare, në shkurtin e vitit 1920, e portretizoi kështu në organin demokratik *Opinga*:

«Me gjithë që ka qenë bijë princi, kjo e dëgjuar shkrimtare ka qenë me gjithësej në mejtimit të shekullit, d.m.th. ka vajtur kurdoherë përpara dhe ka mërëzitur të shkuarën si një kufomë që s'mund të rojë më. Të gjitha simpathit' e saj, të cilat kanë qenë të flakta, e drejtonin ne e ardhmja, ne përparimi, ne vetëqeverimi dhe liria e popujve...» 17)

* * *

Dora d'Istria mbetet një nga figurat ma të shqueme, që ndikoi në lëvizjen kulturore dhe çlirimtare të Rilindjes sonë. E dalun nga mjedisi rumun i viteve 20 të shekullit XIX, e ndërëgjegjëshme për prejardhjen e vet të vjetër shqiptare, ajo u edukue dhe u rrit me mendimet përparimtare evropiane të çlirimit kombëtar dhe të emancipimit të popujve, u ushqye me një kulturë të gjanë dhe dha një kontribut në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore. Në pikëpamje filozofike, ajo ishte ndjekëse e krishtënimit evangjelic, e prirun ma shumë drejtë protestanizmit, kundra ultramontanizmit, dogmave dhe skolasticizmit murgar, kundër pushtetit politik papnor.

Në pikëpamje politike, ajo ishte një mbrojtëse e parimit të lirisë së kombeve, e zhvillimit demokratik të shoqnisë; ishte kundër pushtetit absolut monarkik dhe për një bashkëpunim të gjanë të popujve në fushën e kulturës landore dhe shpirtnore, ishte për-krahëse e flaktë e popujvet të vegjël. Me mendime të tilla filozofike dhe politike, ajo ndërmori një veprim të çmueshëm: nxori në dritë, nëpërmjet letërsisë gojore të popujve, qenjen e kombësive në Evropën jugë lindore dhe, nëpërmjet pohimit të qenjes së këtyne kombësive, me kërkue të drejtat e tyre të ligjëshme për liri kombëtare dhe zhvillim të pamvarun nga fuqitë e hueja shtypëse, tu u mbështetë kryesisht në energjitë dhe forcat vehtiake. Këtu qëndron kontributi i Dora d'Istrias dhe, si vlerësim për këtë, duhet ta kuptojmë karakterizimin që i bëri asaj Dhimitër Kamarda tue e quejtë «Unazë e qytetnimit midis Lindjes dhe Perëndimit», kurse, Xhuzepe Garibaldi, «motër heroike».

Në këtë kuadër duhet kuptue edhe veprimtaria dhe krijimtaria e saj e çmueshme në dobi të çështjes së çlirimit dhe të emancipimit të popullit të vogël shqiptar. Veprat e saja, që pohonin qenjen e lashtë, virtytet burrënore, aftësitë krijuese, dashurinë për liri, tokë dhe drejtësi shoqnore, të drejtat e ligjëshme të popullit tonë, ishin të një kohe me vepra të arbnesëve të shquem De Rada dhe Dh. Kamarda. Krahas këtyne dhe të huejve Ksilander, Bop, Hahn, Shtier, Shlajher, Hashdeu, etj. ajo dha dorë në popullarizimin e çështjes shqiptare në Evropë dhe në Amerikë. Në mënyrë të veçantë, ajo solli si diçka të re vlerësimin e gjeniut krijues shqiptar në atdhe dhe jashtë atdheut. Si e tillë ajo u bë një ndihmuese e lëvizjes sonë kulturore dhe çlirimtare, një ndër-lidhëse e veprimtarisë së arbnesëve të Italisë me

shqiptarë të kolonive të tjera dhe të vendit, një ndërlidhëse e shqiptarëve të shquem me dijetarë të huej, që t'u zgjonte këtyne interesin për gjuhën, folklorin dhe historinë e popullit shqiptar, që këta t'i baheshin krah çështjes sonë. Tue bashkëpunue nëpër organe të njohuna të shtypit evropian, tue përdorë reputacionin e vet të madh si dijetare dhe artiste, gjithkund në mprojtje të çështjes shqiptare, Dora d'Istria bani miq dhe përkrahës në rrethe të ndryshme shkencore dhe artistike evropiane, etj. Pra, jo vetëm me vepra të botueme, si *La nationalité albanaise d'après les chants populaires*, *Les écrivains albanais de l'Italie meridionale*, *Exquisses albanaises*, *Gli Albanesi musulmani*, *Gli Albanesi in Rumenia*, etj., me vepra të pabotueme, p.sh. letrat e dërgueme Jeronim De Radës, Leonardo De Martinos, etj., por edhe me veprimtari të gjallë politike e organizative, për të cilën asht dëshmi veçanërisht epistolari i saj i pasun, Dora d'Istria luejti një rol aq të çmueshëm në çështjen e çlirimit tonë kombëtar, sa që atdhetarët shqiptarë të Rilindjes e mbiquejtën «Ylli i Shqipnisë».

-
1. Sp. De Martino P.L.: *L'Arpa d'un Italo-Albanese*, f. 119.
 2. Sp. Fishta F.: *Dora d'Istria*, po aty, f. 243.
 3. Panzacchi Enrico: *Dora d'Istria*, fash. 1888, botue me rasën e vdekjes së D. d'I.
 4. Sp. Lovera R.: *La letteratura rumena*, Milano, 1908, f. 120.
 5. Sp. Fishta F.: *Dora d'Istria*, po aty, f. 247.
 6. *Enciclopedia Italiana*, ediz. Ist. G. Treccani, 1932, v. XVI, f. 914.
 7. *Larousse*. Grand Dictionnaire Universel du XIX-e siècle, tome sixième, Paris, 1870, f. 1107.
 8. Capidani Th.: *Contributia românilor la renasterea*

Albaniei, ekstrat nga *Graiu Romànesc*, Cluj, II-1928, Nr. 1, f. 5.

9. Kastrati J.: *Letrat e Dora d'Istries*, në *Arësimi Popullor*, maj-qershor 1963, Nr. 3, f. 121.

10. Sp. Vjollca e Skanderbeut: *Mirënjohtësi shqiptare*, në *Shkëndija*, I/1941 Nr. 11-12, f. 10. Përkthimi nga italishtja asht imi.

11. Sp. Vjollca e Skanderbeut: *Mirënjohtësi shqiptare*, po aty; prej këtu nxjerrim vargjet e botueme në *À Dora d'Istria gli albanesi*.

12. nishan.

13. Hidra, vendlindja ime, të gjithë të kanë për mëmë:
Me anije kur çajnë detin, nga mendja nuk të heqin.
Shumë vështirësi ke pasë për ta lartësuar historinë.
Tragjikat' e trimëritë që u vinë t'Arbëreshëvet.

14. Afër qiellit haidhiarë
T'Arbëreshëvet të mjerë,
Një yll i bukur u çfaq
Që largon natën e gjërë.

15. Zonjë fisnike, të durojnë,
ndonëse ti nuk do, më tutje
Ata vëllezër, që gjëllojnë
Përtej detit, mos i le
Nd' errësirë, e bën të venë
Ëmbëlsisht të zënë ndër karta
Posi Athina u madhua dhe Sparta.

16. *Nuova Antologia*, Firenze, dhjetor 1869, riprodhuhet nga Vjollca e Skanderbeut: *Mirënjohtësi Shqiptare*, f. 16.

17. Opinga, shkurt 1920, Nr. 3, f. 47.

BIBLIOGRAFI E PËRGJITHËSHME E PËRDORUN

1. Bala V.: Lidhjet kulturore shqiptare-rumune, në Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës, Shkodër, 1964, ff. 60-72.
2. Breazu I.: Dora d'Istria si Edgar Quinet, Cluj, 1931.
3. Bruto Amante: La Romania Illustrata, Roma, 1888.
4. Capidan Th. Contributia românilor la renesterea Albaniei, ekstrat nga Graful Romanesc, Cluj, II — 1928, Nr. 1.
5. De Martino L.: L'Arpa d'un italo-albanese, Venezia, 1881.
6. Dora d'Istria: La nazionalità albanese secondo i canti popolari trad. di E. Artom, Cosenza, 1867.
7. Enciclopedia Italiana, Ed. Treccani, 1932, v. XVI, zani Ghica, f. 914.
8. Fishta F.: Dora d'Istria, në Shkëndija, v. II, Nr. 7-8, 1942.
9. Kastrati J.: Letrat Dora d'Istrias në Arësimin Popullor, maj-qershor, 1963, Nr. 3.
10. Knorr, Baronessa Giuseppina: Un ricordo a Dora d'Istria, në La Nazione Albanese, Anno I, 15 janar 1897, Nr. 1.
11. Larousse, Grand Dictionnaire Universel du XIX siècle, tome sixième, Paris, 1870, Zani Dora d'Istria, f. 1107.
12. Letrat e Dora d'Istrias dërgue J. De Radës,
Fondi De Rada A.Q.Sh., dosja Nr. 338-536, 54/1.
13. Lovera R.: La Letteratura rumena, Milano, 1908.

14. **Operete Doamnel Dora d'Istria**, trad. de G.G. Peretz, Bucuresti 1876.
15. **Opinga**, shkurt 1920, Nr. 3.
16. Panzacchi Enrico: **Dora d'Istria**, fash. 1888, botue me rasën e vdekjes së D. d'I.
17. Vjollca e Skanderbeut: **Mirënjohtësi Shqiptare, në Shkëndija**, 1/1941, Nr. 11-12.
18. **Di alcune opere della principessa Dora d'Istria** — cenni di Bartolomeo Cecchetti, Venezia, 1868.
19. **A Dora d'Istria gli Albanesi** — Canti pubblicati per cura di D.C., Livorno, 1870.